



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.8(434)

GUSHT 2024

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## FJALA



**GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU: VEPËR ENCIKLOPEDIKE SHUMËDIMENSIONALE**

FAQE 3

## KUVENDI I IX I OBVLP



**TATJANA PARLLAKU (ÇARKAXHIU) ZGJIDHET KRYETARE**

FAQE 5

## REPORTAZH



**TURIZMI MALOR DHE JEHONA E FESTËS SË VILËS**

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

FAQE 8

PROMOVIMI/ Dhjetra personalitete akademike, të letrave e publicistikës vlerësuan veprën enciklopedike të bashkëautorëve Halil Rama e Sakip Cami

# OBVLP FESTOI ME MADHËSHTI 30 VJETORIN E KRIJIMIT

## “30 VJET OBVL”, një libër me vlera të mëdha

### SHPENDI TOPOLLAJ

Janë për t'u përgëzuar dy bashkautorët e librit “30 VJET OBVL - HISTORI SUKSESI”, zotërinjtë e nderuar Halil Rama dhe Sakip Cami, të cilët ashtu pa u ndjerë, punojnë me mish e me shpirt për të pasqyruar me vërtetësi veprimtarinë atdhetare të organizatës tone.

FAQE 3

## Libër me portrete heronjsh e kronika të ngjarjeve reale

Sakip CAMI

FAQE 4

## Së bashku për të ruajtur dhe promovuar vlerat e LANÇ

BASHKIM HISARI

FAQE 4

## ISUF IMERAJ: OBVLP ka përmbushur misionin e saj historik

BASHKIM HISARI

FAQE 4

## Akademi soleme mbresëlënëse

Nexhbedin Basha

FAQE 2

## OBVLP, SIMBOLI VLERAVE TË LIRISË

Nga MEVLUD BUCI

FAQE 4

## 30 VJET OBVLP- HISTORI SUKSESI

www.fjalaelire.com



• Në 30 vjetorin e krijimit, një enciklopedi me portrete të më shumë se 100 personaliteteve të shquara, ish komandantë e drejtues të LANÇ, burgosur e internuar nga sistemi i diktaturës...Dr. Dishnica, gjeneralët Parllaku, Vinçani e Prodani, Liri Belishova, Edip Ohri, Muhamer Spahiu, Josif Zegali, Myfit Guxholli dhe 55 personalitetet drejtuese të LANÇ e shtetit shqiptar, që krijuan OBVL tri dekada më parë



FAQE 2-3

## SUPLEMENTI LETRAT



**Një antologji kozmogonike dhe guximi i poetes Trandafille Molla Baja**

Fatmir Minguli

FAQE 15

FERIT KËPUTA – Mësuesi veteran, studjuesi e shkrimtari që la vepra dinjtitoze

BAJRAM CANAMETI

FAQE 14

## 75 VJET MË PARË

**SI U ORGANIZUA REZISTENCA NDAJ AGRESIONIT GREK TË 2 GUSHTIT 1949**

Historia e centralistit Adem Islam Hoxha që urdhëroi hapjen e zjarrit në kundërpërgjigje të sulmit të agresorëve grek

FAQE 10 - 11

## 80-VJETORI

**RUGA E LAVDISHME E BRIGADAVE TË 16, 17, 18, 19 PARTIZANE**

FAQE 6-7

## OPINION

**KOSOVA MES LUFTËS DHE PAQES**

Bashkim Hisari

FAQE 9

## HEROI

**PËRJETËSIMI I HEROIT TË KOMBIT TAHIR SINANI**

Rajmonda MALEÇKA

FAQE 11

## PROFILI

**DAUT HOXHA, ANALIZA PSIKO-SOCIALE DHE HISTORIA E NJË QYTETI PAFUND**

NGA POL MILO

FAQE 13

## AKADEMI SOLEMNE

## 30 VJET OBVL- HISTORI SUKSESI

• Prezantohet libri me të njëjtin titull i bashkëautorëve Halil Rama dhe Sakip Cami

## Nexhbedin BASHA

Me datë 26 korrik 2024, në ambjentet e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, Tiranë u mbajt Akademia Solemne me rastin e 30 vjetorit të krijimit të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe Pasardhësve.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë anëtarë të OBVL, akademistë, gazetarë, historianë dhe pasardhës të veteranëve të LANÇ. Me këtë rast u prezantua dhe u promovua libri "30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI", i bashkëautorëve Halil Rama dhe Sakip Cami, të cilët pas shtatë monografive të botuara në harkun kohor të 15 viteve, vijnë për lexuesin me këtë enciklopedi, me portrete të më shumë se 100 personaliteteve të shquara, ish komandantë e drejtues të LANÇ, Ushtrisë shqiptare dhe OBVL. Pas fjalës së hapjes nga shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur Halil Rama, pjesëmarrësit ndoqën me interesim të veçantë dokumentarin e përgatitur mjaftë mirë artistikisht nga Sekretarja e Marrëdhënies me Punlikun e kësaj organizate, znj. Mimoza Kurti. Në këtë dokumentar, përveç vlerave të librit, evidentohet më së miri aktiviteti i organizatës dhe personalitetet e saj.

Ishte iniciativa e dhjetra miqve të botës akademike, letrave e publicistikës, politikane e ushtarakë që i mbijetuan sistemit të diktaturës, të cilët me 27 korrik të vitit 1994, me shumë vështirësi, themeluan

30 vjet më parë Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL) dhe Pasardhësve. Në grupin e themeluesve prej 64 personalitetesh të ndritura të historisë sonë kombëtare, gjeneralë dhe luftëtarë, figura politike të respektuara, por të dënuara nga regjimi komunist i sistemit të diktaturës, ishin Dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku "Nderi i Kombit", gjeneral Nexhip Vinçani, Liri Belishova, legjenda e aviacionit shqiptar Edip Ohri, etj, etj, emrat e të cilëve gjenden në libër dhe në historikun e kësaj organizate.

Madhështinë kësaj feste jubilarë ja shtoj padyshim, me pjesëmarrjen dhe përshëndetjen e saj të ngrohtë e miqësore, Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Zv. Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FASë, e cila vlerësoi kontributin e kësaj organizate në këto 30 vjet, si dhe për an-

tarësimin e ushtrisë shqiptare në NATO, integrimin në BE dhe aderimin e saj në organizata homologe në Europë, Kosovë etj.

Për rrugëtimin e OBVL, folën gazetarë, historianë dhe pasues të veteranëve të luftës, dhe konkretisht: Isuf Ymeraj, veterani më i vjetër i kësaj organizate, gazetari e shkrimtari Shpendi Topollaj, gazetari Bashkim Hisari, Nënkrjetar i Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës, prof. Tatjana Dishnica, e bija Dr. Ymer Dishnicës, studiuesi i historisë Mark Palnikaj, veterani i arsimit Mevlud Buci etj. Për vlerat e librit folën bashkëautorët, shkrimtarët dhe gazetarët Sakip Cami e Halil Rama.

Në mbyllje u bënë zgjedhjet në forumet drejtuese. Kryetare e OBVL, u zgjodh Tatjana Parllaku, e bija e të ndjerit,



## 30 VJET OBVL- HISTORI SUKSESI

www.falaeire.com



Gjeneral Parllaku, e cila si pasuese veterani luftime, garantoi se, "do ta ngrejë në një nivel më të lartë aktivitetin e OBVL dhe do të punojë për rritjen aktivitetit të saj dhe shtimin e anëtarësisë me pasardhës të rinj të veteranëve të LANÇ...".

Sekretar i Përgjithshëm u rizgjodh z. Halil Rama, "Mjeshtër i Madh", autor i 26 librave me monografi, publicistikë e kritika letrare, njëherësh prej 22 vitesh edhe Kryeredaktor i gazetës "Veterani".

Si pasardhës veterani luftime i uroj OBVL dhe organizatorëve, suksese të mëtejshme.

Tiranë, 26 korrik 2024.

## PROMOVIMI

## Mirënjohje personaliteteve akademike, të letrave e medias

## Halil RAMA\*

E nderuara gjeneralmajor Manushaqe Shehu!

Endeuara Znj. Gjinovefa Kadriu, këshilltare e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Z. Eri- on Veliq!

I nderuar Nënkrjetar i Org. Vetëranëve të LANÇ të Kosovës Bashkim Hisari!

Të nderuar miq,  
Zonja e zotërinj!

Ju falenderoj për zemërisht dhe ju shpreh mirënjohjen më të thellë, që nga koha juaj e çmuar, edhe në këtë zheg të kësaj vere përvëluese merrni pjesë në këtë event të rëndësishëm.

Në këtë sallë shoh disa personalitete me rrezatim mbarëkombëtar, si:

Veterani më i vjetër Isur Imeraj;  
Prof. dr. Sali Kurti – Mjeshtër i Madh, Qytetar nderi i bashkisë së Matit dhe Personaliteti i Vitit i FPU Tiranë;

Personalitete të botës akademike, të letrave dhe medias si:

Pandeli Koçi; Shpendi Topollaj, Vasil Premçi, Beqir Shehu, Mark Palnikaj; Komisar Sefer Pasha, Hyqmet Zane, Prof. dr. Hajri Mandri; Aferdita Sokolli; Mevlud Buci, Xhavit Lashi, Faik Xhani; Shpetim Cami; Bilbil Dervishi, Perikli Shuli, Nezi Plaku, Mimoza Reçi, Skender Murrja; Dr. Petrit Gjirgji; Kadri Tarelli, Koçi Tahiri, Xhelal Marku, Anila Kodra, Sanie Degjoni-Ndreka, Rajmonda Maleçka, av. Agron Xhedia, Nexh-



bedin Basha (te me fale ndonje tjetër që s'muda tja permende emrin) të cilët kanë qenë mbështetja dhe inkurajimi në procesin tone krijues.

Meqë Organizata e Bashkuar e Veteranëve dhe Pasardhësve të Veteranëve të LANÇ nesër mbush 30 vjet që nga krijimi i saj prej 64 personalitetesh të shquara, ish drejtues të LANÇ, të ushtrisë e të shtetit shqiptar, por fatkeqësisht të dënuar nga diktatura enveriane, unë dhe Sakip Cami, që sëbashku, në harkun kohor të dy dekadave, kemi botuar dhe promovuar edhe shtatë libra tjerë si bashkëautorë, midis të cilëve dy monografi kushtuar gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku dhe para 10 vitesh historikun 20 vjeçar të OBVL, me rastin e 30 vjetorit të kësaj organizate e ndjemë obligim të përmbushnim angazhimin për librin që promovojmë sot.

Ky është një libër në formën e një enciklopedie, ku krahas evidentimit të përmbushjes së misionit historik të

OBVPLANÇ si mbrojtëse e vlerave të lirisë, promovuese e LANÇ dhe transmetuese e saj tek brezi i sotëm dhe ai i ardhshëm, ka në faqet e tij portrete të më shumë se 100 personaliteteve të shquara shqiptare, mes të cilëve do të veçoja ato të dr. Ymer Dishnicës dhe të gjeneralëve madhorë Rrahman Parllaku e Dali Ndreu, që të tre të dekoruar nga Presidenti i Republikës me titullin e lartë "Nderi i Kombit". Dhe për këtë ndjemë kënaqësi të veçantë që sot në këtë veprimtari festive jubilarë, mes nesh janë bijat e këtyre personaliteteve, Prof. Tatjana Dishnica, Tatjana Parllaku e Lavdie Ndreu.

Siç mund të jeni në dijëni, me propozimin e kryesisë së OBVL janë dekoruar me titullin "Nderi i Kombit" edhe gjeneralët Nexhip Vinçani e Veli Dedi. Sërish ndjehemi të lumtur që mes nesh janë pasardhësit e tyre, Ing. Maksim Vinçani, njëherësh nënkryetar i kësaj organizate dhe kryetar i degës së OB-

VLP Elbasan dhe kolonel Ali Demushi, anëtar i kryesisë së OBVL dhe kryetar i degës së saj Shkodër, njëra nga degët më të mira të organizatës tonë në rang kombëtar. Kjo enciklopedi nuk do të ishte në nivelin e pritshmërisë tonë si bashkëautorë, pa konsulencën efektive të nënkretarëve të OBVL, Mjeshtër të Madh Muharrem Gjoka, njëherësh "Qytetar nderi i qarkut Dibër dhe kolonel Trifon Llupo, me kontribut të veçantë në evidentimin e vlerave dhe riorganizimin e OBVL. Pa u zgjatur, dua t'ju shpreh mirënjohje të veçantë miqve të ngushtë, shkrimtarit dhe publicistit të mirënjohur Shpendi Topollaj, autor i më shumë se 75 veprave letrare që zënë vend të rëndësishëm në fondin e artë të letërsisë shqipe dhe prof. dr. Bernard Zotaj, pa ekspertizën e të cilëve, libri "30 vjet OBVL, histori suksesi", nuk do të ishte edhe aq kualitativ dhe në përgjigje të pritshmërisë së lexuesit.

Dhe së fundi, mëqënëse në këto tri dekada kanë humbur jetën dhjetra personalitete themeluese dhe drejtuese të kësaj organizate, mes të cilëve katër kryetarët: dr. Ymer Dishnica, gjeneral Rr. Parllaku, kolonelët Myfit Guxholli e Sotir Budina si dhe kryetari legjendë i degës së OBVL Korçë Fluturak Vinçani, ju ftoj që në nderim të kujtimit të tyre të mbajmë një minutë heshtje....

I përjetshëm kutimi i tyre....

\*FJALA E HAPJES NË PROMOVIMIN E LIBRIT "30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI"

## JUBILARE

Fjala në promovimin e librit "30 VJET OBVL-HISTORI SUKSESI" të bashkëautorëve Halil Rama dhe Sakip Cami

# GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU: VEPËR ENCIKLOPEDIKE SHUMËDIMENSIONALE



va e tij, si një nga komandantët legjendarë të njësive kryesore të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe të Ushtrisë Shqiptare.

Sot e përkujtojmë atë si sfidantin e tri kohërave, gjeneralin legjendar që bëri epokë. Ai doli fitimtar nga lufta antifashiste nacional-çlirimtare, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në betejën për pavarësinë e Kosovës dhe para 5 vitesh ishte gjenerali më i vjetër, por me mendjen e re që mbështeste anëtarësimin e Shqipërisë në BE dhe të ushtrisë shqiptare. Me gjeneral Parllakun ndihemi krenar të gjithë.

Po ashtu, kam njohur dhe vlerësuar

kontributin e dhjetra themeluesve të organizatës tuaj, për pjesëmarrjen aktive gjatë LANÇ, ish-gjeneralë e kolonelë që luajtën rol të rëndësishëm në krijimin dhe konsolidimin e ushtrisë e të shtetit shqiptar.

Më së miri vlerësohet roli dhe kontributi i tyre, si dhe i 15 mijë anëtarëve të organizatës tuaj që milituan në të gjatë 30 viteve, duke përbushur misionin e saj historik, të ruajtjes, mbrojtjes e zhvillimit të vlerave të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë italianë e nazistëve gjermanë, nga më të lavdishmet për liri e pavarësi të shqiptarëve në

trojet e tyre etnike në Ballkan dhe që e renditi Shqipërinë përkrah fituesve të Luftës së Dytë së Botërore.


Ato pasqyrohen më së miri në librin e bashkëautorëve Rama e Cami, të cilët gjej rastin t'i falenderoj për këtë vepër enciklopedike me rëndësi shumëdimensionale, që hyn me dinjitet në fondin e letërsisë sonë dokumentare. Në 80 vjetorin e çlirimit të atdheut dhe 30 vjetorin e OBVL, ky libër modest është një kontribut për të njohur të kaluarën e lavdishme, për të vlerësuar të sotmen dhe për të projektuar të ardhmen.

Me këtë rast dua t'ju falenderoj ju pasardhësve për vazhdimin e veprës së veteranëve të LANÇ, e në veçanti Znj. Tatjana Parllaku, të cilën pata fatin ta njihja e të bashkëpunoja ngushtë me të për 10 vjet kur ishte si Ndihmëse për arsimin, kulturën, shëndetësinë dhe shkencën, pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Ajo ka qenë pjesë e Grupit të Punës në mbrojtje të Monumenteve të Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar në përfshirjen e qyteteve të Gjirokastrës dhe të Beratit në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Duke përfunduar më lejoni t'ju uroj sërish:

**GËZUAR 30 VJETORIN E OBVL-së!  
SUKSESE TË MËTEJSME NË MISIONIN TUJ HISTORIK!**

Faleminderit.



**E**prita me kënaqësi të veçantë ftesën për të qenë e pranishme në kremtimin e 30 vjetorit të Organizatës tuaj dhe promovimin e librit të bashkëautorëve Halil Rama e Sakip Cami, kushtuar këtij event historik.

Më lejoni që në fillim t'ju uroj përzemërsisht:

Gëzuar këtë jubile të lavdishëm të organizatës tuaj!

Kam patur fatin të njihem nga afër me, gjeneral Parllakun që e drejtoj për dy dekada me përkushtim të rrallë OBVL-në dhe të mësoj shumë nga përvo-

## LIBRI



## SHPENDI TOPOLLAJ

**J**anë për t'u përgëzuar dy bashkautorët e librit "30 VJET OBVL - HISTORI SUKSESI", zotërinjtë e nderuar Halil Rama dhe Sakip Cami, të cilët ashtu pa u ndjerë, punojnë me mish e me shpirt për të pasqyruar me vërtetësi veprimtarinë atdhetare të organizatës tonë.

Tre dekada nuk janë pak për të treguar se sa të drejtë kishin ata burra që e krijuan në korrikun e vitit 1994 këtë organizatë, që kishte si objektiv kryesor jo vetëm nderimin e vlerave historike të luftës Naciona-

## "30 VJET OBVL", një libër me vlera të mëdha

lçlirimtare, sakrificat e panumërta që u bënë për të na çuar në fitore, shembullin e paharruar të atyre djemve dhe vajzave që dhanë jetën e tyre të re në këtë luftë heroike, ndihmën dhe përkrahjen që njerëzit e thjeshtë i dhanë asaj, ndriçimin e së vërtetës nga falsifikimet që diktatura i bëri asaj periudhe, dënimin qoftë dhe moralisht e politikisht të krimeve të komunizmit, domosdoshmërinë për bashkim e mirëkuptim mes shqiptarëve, ngritjen e zërit për problemin madhor të Kosovës e Çamërisë, por edhe rehabilitimit të atyre kuadrove drejtuese dhe nacionaliste që çmenduria dhe pashpirtësia i goditi pa mëshirë me akuza nga më absurdet, duke e shtrirë hakmarrjen deri te familjet e tyre. Shumë nga ata nuk janë më midis nesh, por kushdo e di sesa fisnikë u treguan ata si gjatë vuajtjeve deri ndër burgje e internime, ashtu edhe kur në Shqipëri proceset demokratike triumfuan.

Nga të gjithë kishte ç'të mësoje, por dashje pa dashje, Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, gjeneral Rrahman Parllaku u shndërrua në simbol virtyti që me fjalën dhe sjelljen e tij i dha organizatës tonë një profil paqej, dashurie e harmonie me këdo, pa-

varësisht bindjeve të tij.

Besnikë të këtij amaneti, ne si me shkrimet tona, ashtu dhe me veprime kemi dashur të japim edhe një shembull kaq të nevojshëm për shoqërinë tonë sot: morëm takim si kryesi me kryesinë e shoqatës së organizatës së LANÇ që me të drejtë i konsiderojmë vëllezërit tanë dhe u propozuam bashkimin, pasi asgjë nuk na ndante.

Kryetari, Prof. Hulusi Hako si gjithmonë i arsyeshëm na kuptoi drejtë, por më pas me keqardhje konstatuam se nuk ja kishin miratuar të tjerët qëndrimin për bashkimin e organizatave tona që janë të dyja Nderi i Kombit.

Më pas lexuam në shtyp edhe kundërvënien dhe qortimet që iu bënë atij nga një grup anëtarësh që duke u hequr sikur janë për parimet e Luftës Nacional Çlirimtare, harrojnë se Konferenca e Pezës qysh në vitin 1942 bënte thirrje për bashkim pa dallim feje, krahine dhe ideje. Kurse ata sot pas 82 vjetësh, duan ta nxisin përçarjen mes shqiptarëve.

Ne, trashëgimtarët e atyre prindërve që bënë sakrificat të panumërta dhe nuk i lëshuan për asnjë çast armët nga dora për shpor-

rjen e okupatorit, nuk arrijmë ta kuptojmë qëndrimin e atyre që duan të duken si pronarë të luftës dhe dëshmorëve tanë, përveç se si një fatkeqësi për synimin tonë euroatlantik. Se mendoni se sa dëm i bëjmë atdheut, kur bota sheh se ende dalin disa kalorës mjeranë heshtëthyer në mbrojtje të diktaturës dhe diktatorit.

Por ne, në asnjë rast nuk u jemi përgjigjur të tillëve që nuk u ka bërë asnjë përshtypje as jeta dhe vepra e figurave madhore që autorët Rama dhe Cami kanë përjetësuar në librin e tyre "30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI", që u promovua më 26 korrik 2024 në sallën e Librit Akademik të Akademisë së Shkencave në Tiranë. Këta njerëz të nderuar që historia do të përulet me respekt, për ata trumykurit kanë mbetur armiq, spiunë, agentë e poliagentë të komunizmit.

Ja pse libra të tillë, me të vërtetat e tyre, janë mëse të domosdoshëm. Prandaj kanë një meritë të madhe këta dy autorë që në heshtje dhe pa bujë punojnë pa u lodhur sipas parimit të Mark Tveinit se "Zhurma nuk provon asgjë. Shpesh pula që bën vetëm një vezë, kakarit sikur bën një asteroid".

## FJALA

# Libër me portrete heronjsh e kronika të ngjarjeve reale

Nga Sakip CAMI

**K**y libër, i teti së bashku me publicistin e shquar Mjeshtër të Madh Halil Rama, i teti në zhanrin e monografive, përveç librave që kemi shkruar në mëvetësinë tonë, i kushtohet dhe pasqyron veprimtarinë e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve e të Pasardhësve të Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar në këto 30 vjet.

Baza e këtyre shkrimeve është e vërteta, kronika reale e ngjarjeve, e pasqyruar në kohë reale në gazetën "Veterani", me kryeredaktor Halil Ramën, njëkohësisht sekretar i përgjithshëm i OBVL dhe zv kryeredaktor Sakip Camin, sekretar për marrëdhëniet me organizatat homologe në Europë



dhe Botë, përzgjedhur për botim në libër. Përveç veprimtarisë së drejtuesve të OBVL Ymer Dishnica, Rrahman Parllaku, Myfit Guxholli e Sotir Budina si dhe të drejtuesve të tjerë në krye-

si e në rrethe, në këtë libër gjen jetën e veprimtarinë e drejtuesve të LANÇ, të dënuar nga diktatura si Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Rrahman Parllaku, Dali Ndreu, Nexhip Vinçani,

Gjin Marku etj, të drejtuesve të tjerë si Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica, Tuk Jakova, Liri Belishova etj.

Në kuptimin e plotë të fjalës ky libër është kujtesë kombëtare për vitet e LANÇ që do tu nevojitet brezave.

Një falenderim i veçantë shkon për zonjën Tatjana Parllaku, të bijën e Gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku, e cila i grumbulloi të gjitha fjalimet e gjeneralit si kryetar i OBVL në ceremonitë mortore të shokëve të luftës, i korektoi nga ana gjuhësore dhe dha ndihmesën e saj.

Ju falenderoj nga zemra për pjesëmarrjen tuaj, duke sfiduar vapën e nxehtë të korrikut.

Së bashku do t'a ruajmë fort trashëgiminë tonë atdhetare dhe do tua transmetojmë brezave.

## BASHKIM HISARI: Sëbashku për të ruajtur dhe promovuar vlerat e LANÇ



në varetat e dëshmorëve dhe heronjve të popullit. Në fillim të programit zyrtar, nxënësit e shkollave, me flamuj kuq e zi përshëndetnin të pranishmit. Pastaj orkestrat luanin motive nga këngët partizane. Tubimet i hapnin veteranët. Të pranishëm ishin përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe ato partiake. Flisnin për rëndësinë e LANÇ. Por, tani gjithnjë e më pak po veprohet kështu. E tëra ngeli si një ëndërr dhe dëshirë e veteranëve dhe pasardhësve të tyre. Tani po shënohet Dita e Evropës.

Ne, dy organizatat tona: OBVL dhe OVLANÇ të Kosovës, përherë kemi qenë jemi bashkë për të ruajtur dhe promovuar vlerat e LANÇ. Për realizimin e këtyre synimeve kemi vendosur marrëdhënie të shkëlqyera. Me rëndësi është edhe bashkëpunimi me gazetën "VETERANI", e cila në Kosovë, ku nuk botohet asnjë gazetë e printuar, e plotëson këtë boshllëk. Shpreh bindjen se edhe në ardhmen do të vazhdojë ky bashkëpunim për promovimin e antifashizmit, vlerave të atdhetarisë, barazisë, demokracisë dhe paqes, për të respektuar, kujtuar dhe nderuar luftëtarët e lirisë, heronjtë dhe dëshmorët dhe të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë e të Kosovës.

**N**ë emër të Kryesisë së Org.Veteranëve të LANÇ të Kosovës i uroj OBVL 30-vjetorin e krijimit të saj. Në ditët e bukura të majit, disa mijëra njerëz mbledheshin në sheshin kryesor të Prishtinës, pranë bustit të heroit Emin Duraku në Gjakovë, në kompleksin memorial të Lidhjes së Prizranit etj, për të festuar fitoren kundër fashizmit, njëherën ndër momentet më të rëndësishme në historinë tonë. Vendoseshin kurora dhe lule të freskëta



## ISUF IMERAJ: OBVL ka përmbushur misionin e saj historik

**T**ë nderuar pasardhës të veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare! Si më i vjetri i kësaj organizate, dua t'ju falenderoj për zemërsisht për kontributin tuaj, duke u bërë promotorë të organizimit dhe konsolidimit të saj.

Para 20 vitesh, kur me gjeneral Parllakun i propozuam Halil Ramës të merrte drejtimin e gazetës "Veterani", patëm bindje në aftësitë e tija profesionale si gazetar dhe shkrimtar, dhe nuk u zhgënjëm.

Jo vetëm në gazetën tonë "Veterani", por edhe në shtypin qëndror, madje edhe me gjashtë libra, kushtuar gjeneral Parllakut e historikut të OBVL, Halil Rama ja doli ta promovojë dhe t'ja ngrejë prestigjin kësaj organizate të krijuar para 30 vitesh nga burra shteti, siç ishin Dr.Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku, Edip Ohri, Tahir Voshtina, Liri Belishova, Muhamer Spahiu, Hamit Neziri, Shaban reçi, Hamit Keçi e dhjetra të tjerë.

Sot jam më i gëzuar se kurrë për faktin se të pasardhësit shoh të përmbushur misionin e organizatës tonë: mbajtjen gjallë të frymës patriotike, ruajtjen dhe promovimin e vlerave të luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare dhe mbështetjen e proceseve demokratike.

Si përfundim, nuk më mbetet gjë tjetër, veçse t'ju uroj suksese të mëtejshme.

Faleminderit

## OBVL, SIMBOLI VLERA VE TË LIRISË

### Respekt dhe mirënjohje kryeredaktorit të gazetës "Veterani" Hali Rama, "Mjeshtër i Madh"



MEVLUD BUCI

WWW.FJALRELIRE.COM  
REVISTA: "ALBANIAN POST" LONDËR

Mevlud Buci

Nga MEVLUD BUCI

**M**e 26 korrik 2024, në një ceremoni solene, në një veprimtari prekëse, u shënuar 30 vjetori i OBVL (Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe Pasardhësve)

dhe promovimi i librit "30 VJET OBVL-HISTORI SUKSESI" i bashkëautorëve Halil Rama dhe Sakip Cami, historia e i kësaj organizate që vlerëson veteranët e Luftës së Dytë Botërore, dënon krimet e komunizmit, mbështeti Luftën e Kosovës dhe Çështjen Mbarëkombëtare. Duhet thënë se kjo Organizatë e fuqishme e veteranëve, e përfaqëson zërin e saj nëpërmjet gazetës "Veterani", drejtuar me kompetencë profesionale nga Halil Rama, "Mjeshtër i Madh", por edhe nëpërmjet shtrirjes së saj të Degëve në gjithë Republikën, duke u bërë një përçuese e denjë e vlerave kombëtare të lirisë, të traditave dhe atdhetdashurisë. Në fjalët përshëndetëse të mjaft pjesëmarrëseve, si: gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Hali Rama, Isuf Imeraj, Shpend Topollaj, Sakip Cami, Mark Palnikaj, Bashkim Hisari etj, u vu në

dukje roli i kësaj organizate si transmetuese e vlerave luftarake të lirisë, si organizatë e frymëzuar vetëm me ideale kombëtare të vlerave të lirisë dhe të patriotizmit. Vazhdimisht kjo vlerë është përcjellë nëpërmjet gazetës "Veterani", drejtuar me profesionalizëm nga Halil Rama "Mjeshtër i Madh" dhe nga libri "30 VJET OBVL-HISTORI SUKSESI" ku përcillen shkrime nga figura të shquara, si: gjeneral Rrahman Parllaku - Nderi i Kombit, Liri Belishova, Hava Bekteshi, Skënder Malindi etj, si dhe deklaratat e prononcime në favor të çështjes kombëtare.

Mirënjohje pafund për ju organizatë e dashur dhe e nderuar e OBVL, si dhe të nderuarit kryeredaktor të gazetës "Veterani", Hali Rama, akademik dhe "Mjeshtër i Madh".

OBVL përfaqëson një vlerë të rëndësishme të traditave të lirisë dhe demokracisë.

## FORUMET

## KUVENDI I IX I OBVL P,

## Tatjana Parllaku (Çarkaxhiu) zgjidhet kryetare

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve, pas ceremonies festive të 30-vjetorit të krijimit, më 26 korrik 2024 mbajti edhe Kuvendin e saj të IX-të Kombëtar.

51 delegatët e degëve të saj nga 12 qarqet e vendit, fillimisht ndoqën raportin analitik të mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm Halil Rama dhe e vlerësuan atë për karakterin objektiv në përmbushjen e misionit historic të OBVL P-së si ruajtëse dhe promovuese e vlerave të lirisë.

Më pas Kuvendi miratoi propozimet e bëra në emër të Kryesisë së OBVL P-së nga sekretari organizativ Kole Dedaj.

## KUSH ËSHTË

## TATJANA PARLLAKU – ÇARKAXHIU

Pas vdekjes më 28 shkurt 2024, të ish kryetarit, kolonel Sotir Budina, Kuvendi zgjodhi kryetare të OBVL P-së Znj. Tatjana Parllaku – Çarkaxhiu.

Ajo, ka mbaruar studimet në degën e Gjuhë Letërsisë, në Fakultetin e Histori Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, në vitin 1975.

Ka dhënë mësim në lëndët Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë Italiane dhe Gjuhë Ruse. Ka monitoruar reformën zgjedhore në Shkollat e Larta dhe Universitete, si dhe gjatë, gjithë karrierës së gjatë në arsim ka edukuar tek brezat e rinj kurajon, vetëbesimin dhe dashurinë për dijen, duke inkurajuar zhvillimin e tyre të mëtejshëm intelektual.

Me moton: “Mësuesit janë ata, që krijojnë dhe frymëzojnë ëndrrat dhe mendjet e së ardhmes”, ka ushtruar profesionin e mësuesit me pasion e përkushtim për 26 vite rresht.

Ka punuar për më shumë se 10 vjet si Ndihmëse për arsimin, kulturën, shëndetësinë dhe shkencën, pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Ka qenë pjesë e Grupit të Punës në mbrojtje të Monumenteve të Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar në përfshirjen e qyteteve të Gjirokastrës dhe të Beratit në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Është aktiviste në mbrojtjen e të drejtave të, të përndjekurve politikë, fëmijëve, grave, moshës së tretë dhe shtresave ne nevojë. Është pjesë e kryesisë të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare, dhe që prej Kuvendit të 7-të, kryen funksionin e Sekretares për marrëdhëniet e OBVL-ës me institucionet shtetërore.

Është dekoruar me Medaljen e Mirënjohjes, dhënë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Dekret Nr. 5429. Datë 23.07.2007 “Në shenjë mirënjohjeje për ndihmesën e dhënë në realizimin me sukses të detyrave të Institucionit të Presidentit të Republikës”.

Kuvendi shprehu bindjen se me këto cilësi dhe në gjurmët e përvojës së babait të saj, gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku, ajo do ta kryejë më së miri funksionin e kryetares së OBVL P-së.



## FORUMET E REJA DREJTUESE

Kuvendi i IX-të i OBVL P-së votëbesoi gjithashtu Z. Halil Rama - Mjeshtër i Madh në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të OBVL P-së; si dhe nënkryetarët aktualë: Muharrem Gjoka, Mirjana Ohri e Maksim Vinçani dhe Z. Sakip Cami në funksionin e Sekretarit për marrëdhëniet me organizatat homologe në botë.

Pas dorëheqjes së prof. Tatjana Dishnica nga funksioni i nënkryetares së OBVL-ës, Kuvendi zgjodhi në vend të saj nënkryetar të OBVL P-së kolonel Trifon Lllupon, i cili për më shumë se 10 vjet kryen funksionin e sekretarit të protokollit dhe financës së OBVL-ës dhe ka dhënë kontribut maksimal në konsolidimin e strukturave të kësaj organizate.

Me propozimin e kryesisë, në funksionin e Sekretarit organizativ dhe marrëdhëniet e OBVL P-së me institucionet shtetërore dhe të Shoqërisë Civile që kishte znj. Tatjana Parllaku u zgjodh Znj. Mimoza Dilavar Kurti, mësuese e talentuar e letërsisë – njëhërësh gazetarë, skenariste dhe montazhiere, me disa diploma e çertifikata të fituara edhe në Amerikë. Ajo i është përkushtuar studimit të historisë, duke eksploruar në terren venburimet ku babai i saj, arkeologu dhe etnologu i mirënjohur Dilaver Kurti zbuloi thesare të arkeologjisë dhe etnokulturës matjane. Pikërisht për këtë kontribut ajo u vlerësua nga Federata e Paqes Universale Shqipëri me titullin “Ambasadorë për Paqe”.

Gjithashtu Kuvendi zgjodhi Znj. Rajmonda Maleçka – gazetare, poete dhe shkrimtare me përvojë të gjatë pune të zgjidhet Sekretare për marrëdhëniet me publikun të OBVL P-së.

## NJË NDRYSHIM NË STATUTIN E OBVL P-SË

Me propozimin e Kryesisë, Kuvendi i IX-të Kombëtar i OBVL P-së vendosi që neni 1 i Statutit të miratuar në Kuvendin e parafundit, të datës 22.05.2021, të ndryshohet si vijon:

Organizata mban emrin: “Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Popullit shqiptar dhe dhe pasardhësve”, me Logo - O B V L – me shkurtime. Ajo vepron si OJF - (Organizatë Jo Fitimprurëse) në përputhje me Ligjin përkatës dhe Vendimin Nr.5138, datë 31.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për Regjistrimin si person Juridik të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës”.

Nenet e tjera të Statutit të miratuar në Kuvendin e OBVL-ës, të datës 22.05.2021, mbeten në fuqi.

## TATJANA PARLLAKU: TË PERÇOJMË TE BREZAT E RINJ PATRIOTIZMIN DHE ATDHEDASHURINË

Ndjem e nderuar dhe e vlerësuar që, si pasardhëse veterani, u zgjodha sot Kryetare e OBVL P-së. Na takon ne pasardhësve të veteranëve që vunë rininë e tyre në shërbim të lirisë dhe dhanë jetën në luftë me okupatorin nazifashist, të perçojmë te brezat e rinj patriotizmin dhe atdhedashurinë. Ne mbetemi të angazhuar totalisht për arritjen e bashkimit dhe pajtimit kombëtar sipas idealeve dhe mesazheve të Konferencës së Pezes që janë aktuale edhe në ditët e sotme. Ne veteranët dhe pasardhësit, të bashkuar me frymën e mirëkuptimit dhe tolerancës do të promovojmë më mirë vlerat patriotike dhe traditat luftarake të LANÇ-it duke u transmetuar breza mesazhin se interesat e atdheut qëndrojnë mbi interesat e Partive, ato janë të shenjta dhe mbrohen më mirë kur jemi të bashkuar.

OBVL P-ja është dhe do të mbetet një Organizatë patriotike pluraliste, e pavarur nga Partitë Politike që do të vazhdojë të punojë dhe të luftojë me përkushtim për të qenë shtylla dhe krahu i shtetit dhe kombit shqiptar.

Ne do të punojmë për mbrojtjen e statusit të veteranit dhe pasardhësit të veteranit të LANÇ-it, të invalidit të LANÇ-it, të familjeve të dëshmorëve, dhe të drejtave të tyre social-ekonomike.

Do mbrojmë objektet, lapidarët dhe pllakat përkujtimore të luftës çlirimtare.

Ne pasardhësit e veteranëve, pjesëtarët e familjeve të dëshmorëve të atdheut dhe oficerët në pension dhe të liruar, të frymëzuar nga patriotizmi kombëtar, të bashkuar me organizatën e Veteranëve të Kosovës do të punojmë përpara traditat luftarake të të parëve tanë për vazhdimin e punës sonë në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, si anëtare e Organizatave Botërore dhe Europiane të Veteranëve, ku bëjmë pjesë.

Ne do të vazhdojmë bashkëpunimin me organizmat shtetërore dhe organizatat jo qeveritare në mbrojtje të të drejtave të veteranëve dhe pasardhësve të tyre si kudo në Evropën e Bashkuar, pjesë e plotë e së cilës ndjehemi që sot. Duke ju falenderuar edhe njëherë për besimin, ju premtoj se do të punoj me përkushtim për të përmbushur me sukses detyrën engarkuar. Faleminderit!



## 80 VJETORI

## 80 vjet nga formimi i Brigadës së 16-të Sulmuese

Më 20 gusht 2024 mbushen plot 80 vjet nga formimi i Brigadës së 16-të Sulmuese, e cila u krijua më 20 gusht 1944 me luftëtarët e një batalioni të Beratit, dy batalione të Mallakastrës dhe me një çetë vullnetare të Lushnjes me rreth 465 luftëtarë të organizuar në tre batalione. Për një kohë fare të shkurtër numri i luftëtarëve u dyfishua.

Brigada pati këtë inkursion luftarak:

Në ditët e fundit të muajit gusht 1944 forcat e saj organizuan një varg pritash kundër autokolonave armike në rrugën Berat-Lushnje. Me 2 shtator ato sulmuan nazistët gjermanë në Mbrostar dhe, pasi i shpartalluan, dogjën pesë depo me municion e material tjetër ushtarak. Gjatë luftimeve këtu u zunë qindra pushkë, dhjetra mitralozë e municion i shumtë dhe



radhët e brigadës u shtuan me qindra bij e bija të Myzeqesë.

Më 8 shtator 1944, një batalion i

brigadës goditi një autokolonë prej 15 maqinash me nazistë gjermanë në rrugën Fier-Lushnjë. Me 13 shtator

1944 brigada sulmoi në befasi nazistët gjermanë brenda në aytetin e Fierit dhe preu rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë. Pasi u shkaktoi dëme të mëdha armiqve, ajo u tërhoq në fshatrat për rreth Fierit.

Prej kësaj kohe dhe deri në dyjavëshin e parë të tetorit '44, forcat e Brigadës 16-të Sulmuese, të vendosura në pozicione luftimi gjatë rrugës Fier-Vlorë, Fier-Lushnje dhe Berat-Lushnje goditën pa rreshtur kolonat gjermane në tërheqje.

Me 15 Tetor 1944 forcat e Brigadës 16-të Sulmuese çliruan Fierin, ndërsa më 20 Tetor një pjesë e tyre ndihmoi Brigadën e 8-të për çlirimin e Lushnjes. Armiku la mbi 100 të vrarë, shumë të plagosur dhe materiale luftarake. Ne humbëm 56 partizanë trima.

Lavdi të rënëve! Lavdi edhe atyre që vdiqën në liri po me ato ideale të Luftës!

## Kur gjeneral Nexhip Vinçani përshëndeste krijimin e Brigadës XVII S

80 vjet më parë, me 26 shtator 1944, në vendin e quajtur Fushë e Kuqe, në fshatin Gjinar të Shpatit të Elbasanit, u formua Brigada XVII Sulmuese Partizane. Në ditën e përbërimit, në përbërjen e Brigades XVII-S u futën batalionet e qarkut të Elbasanit: Batalioni Dumre – Darsisë, i Shpatit "Naun Panxhi", i Bërzeshes, i Verçë-Sulovës dhe ai i Polisit. U zgjodh fshati Gjinar sepse ai ishte në qendër të veprimeve luftarake të këtyre batalioneve.

Përveç këtyre u rreshtuan edhe 94 te rinj nga qytetit i Elbasanit dhe nga terr'eni. Pra brigada përbëhej nga 1592 partizanë, nga të cilët 1012 nga rrethi i Elbasanit, 282 nga rrethi i Librazhdit, 119 nga rrethi i Gramshit dhe pjesa tjetër nga rrethe te tjerë. Mbi 90 % e partizaneve ishin nën moshën 25 vjeç.

Për drejtimin e Brigadës, në ditën e inaugurimit, u zgjodh shtabi i cili përbëhej nga Gjeli Argjiri - komandant; Qamil Guranjaku-komisar; Ndreçi Plasari- zv/komisar; Sefedin Meçe-zv/komandant; Nebi Agolli-pergjegjes rinie, Nexhdet Deveja -axhitprop; Shaqir Tabaku-intendent.

Ne shtabet e batalioneve komandantë e komisarë ishin respektivisht:

Në batalionin I të Dumresë; Petrit Hakani e Llambi Peçini,

Në batalionin II: Sami Leka e Beqir Dervina;

Në batalionin III, Veniamin Hazizi dhe Kadri Abdihoxha, në batalionin IV Muharrem Çota ( Hoxhë Cota), Niko Dilo .

Në radhët e Brigadës së 17 S u rreshtuan edhe shoqe si Jolanda Xhuvani, Shegushe Hakani, Alipi Dedja, Burbuqe Gjergji, Emine Guranjaku, Ikbale bylyku, Parashqevi Gjini, Afërdita tërova, Hedije Tola, Diamante dilo, etj.. Pjesa më e madhe e këtyre shoqeve vininnga fronti I luftës ku kishin marrë pjesë në veprime luftarake e kishin zhvilluar veprimtari tëdendur politike.

Në ditën e inaugurimit në orën 11.00 Komisari i Brigadës Qamil Guranjaku i paraqiti forcën Zihni Muçës, sekretar polirik i Qarkorit. Në emër të Shtabit të Përgjithshëm përshëndeti i deleguari i këtij Shtabi, Nexhip Vinçani i cili i dorëzoi flamurin e Brigadës 17 komisarit Qamil

Guranjaku.

Të nesërmen e krijimit të të Brigadës u formua edhe Divizioni IV Sulmues dhe ajo u bë pjesë e këtij formacioni të madh luftarak dhe në përbërje të tij kreu veprime luftarake te shumta.

Përkjeka e parë me armikun u bë në Darsi të Peqinit me 2 tetor 1944, ku shpartalloi banden balliste te Hamit Matjanit e çliroi krahinën duke vendosur pushtetin e keshillave Nac-CI. Në këto luftime të ashpra ra ne fushen e betejes partizani Rrahman Lato dhe u plagos komandanti i batalionit Muharrem Çota.

Me 5 tetor brigada sulmoi një autokolonë gjermane ne rrugen Elbasan-Peqin ku iu shkatuan armikut dëme të mëdha.

Pas ketyre veprimeve luftartake Brigada XVII u ngarkua të vepronte ne rajonin e Qafes së Kërrabës, per te goditur postat dhe kolonat gjermane gjatë rrugës Elbasan-Tirane dhe Elbasan - Peqin.

Nga 24 tetori 1944 deri me 16 nentor 1944, brigade ka bere 23 goditje kunder kolonave gjermane nga te cilat 9 jane bere ne rrugen Elbasan-Peqin dhe 14 goditje ne rrugen Elbasan-Tirane.

Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm brigada u kthye në luftimet per clirimin e Tiranës, duke u vendosur në Mullet e Lundër dhe me 13 nëntor 1944, kreu sulmin mbi autokolonën gjermane të grupit "Steyker", Qafë-Krrabë-Tiranë. Në Fikas e Ibë ajo së bashku me forca të tjera partizanë i shkaktoi armikut humbje të rënda. Në betejën e Mushqetas me 13-14 nëntor 1944 armiku u dëmtua rendë prej luftës partizanë.

Kur kryeqyteti ndodhej i rrethuar nga forcat partizane Brigada siguronte shpinen dhe krahet e tij. Në Mushqeta rreth 1000 luftëtarë të Ushtrisë Nac-CI u ndeshen me 3000 ushtarë hitleriane ne nje lufte per jete a vdekje. Komandes armike i kishte mbeture 1000 hitleriane te vrere dhe tok me to dhe deme shume te medha materiale. Pjesa e armiqve qe mbeten gjalle u kapen rob.

Ne keto luftime te ashpra rane heroikisht ne fushen e betejes 11 luftetare të Brigadës XVII-



S, midis te cileve komisarit trim i batalionit III, biri i lavdishëm i popullit te Elbasanit, intelektual Kadri Abdihoxha.

Pas clirimit te Tiranës brigada mori urdher per te kaluar ne qarkun e Dibres. Duke spas-truar qarkun nga mbeturinat e bandave, forcat e Brigades XVII dhe ato te XVIII shfarosen banden e Halil Alise. Nga Dibra, në janar te 1945, kreu nje sere veprimesh spastrimi nga mbeturinat e reaksionit ne Kruje, Ishem, Mat e Mirdite.

Përveç detyrave luftarake, Brigada XVII kreu edhe detyra te tjera te rendesishme politike ne drejtim te vendosjes e te forcimit te pushtetit popullor ne krahinat e Dumrese, Darsise, Peqinit, Krrabes, Krujes, Ishmit , Mirditës, Matit, Bulqizës e, Peshkopisë.

Brigada i kreu me nder detyrat e ngarkuara. Ajo shkroi si gjithë brigadat e tjera faqe lavdie dhe heroizmi. Ajo i dha lirisë 31 deshmorë për të cilët përulemi me nderim të thellë dhe do të kujtohen në jetë të jetëve për veprën e tyre sublime. Ajo është e do të jetë një shembull frymëzimi për pasardhësit e veteranëve , që të mbajnë gjallë përjetë atdhedashurinë e lavdinë e luftës partizane.

## 80-VJETORI

## Rruga e lavdishme heroike e Brigadës së XVIII-të

• **BRIGADA XVIII SULMUESE E UNÇSH u formua në Sllatinë të Peshkopisë më 18.8.1944, nga batalionet partizane të Dibrës, Çermenikes e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, që u organizuan në katër batalione. Më 22.8.1944 forcat e saj, së bashku me forcat e Br. V S zhvilluan me sukses luftimin e parë mësymës kundër forcave gjermane e reaksionare të përqendraara në malin e Korabit. Nga ky sulm armiku pati shumë humbje dhe dështoi operacioni «Filksenjagd», që synonte të pushtonte Peshkopinë.**

**P**ara 80 vitesh, më 18.8.1944, në Sllatinë të Dibrës u formua Brigada e XVIII S nga batalionet partizane të Dibrës, Çermenikës e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, që u organizuan në katër batalione.

Komandat i Brigadës XVIII S. qe Esat Ndreu dhe zëvendëskomandant Zoi Themeli, komisar Miço Kallamata dhe zëvendëskomisar Sotir Vullkani.

Më pas, komandant brigade kanë qenë edhe Zoi Themeli e Petrit Dume, ndërsa zëvendëskomandant kanë qenë edhe Petrit Dume e Xhevdet Petrela. Komisar qe edhe Ilmi Çausholli dhe zëvendëskomisar qenë edhe Temo Sejko e Milo Qirko; përgjegjës rinie Dhori Shkodrani, sektori i Agjitpropit: Qazim Prishtina (përgjegjës) Muntaz Kodra, Servet Tershana; intendent: Mahmut Ndreu, Bardhyl Papajani, Kin Dushi, oficer i mbrojtjes Mustafa Novi, oficer informativ Sakip Luku, oficer në sektorin informativ Zenulla Uka (përgjegjës i seksionit).

Brigada që në fillim, sipas detyrave që kishte marrë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ, nën drejtimin e komandës sonë veprimi së bashku me Brigadat e I, IV, e të V Sulmuese për asgjësimin e sulmeve që ndërmerrnin forcat gjermane e bashkëpunëtorët e tyre, si ajo e mësymjes së tyre nga Hilmia, por u shpartalluan dhe më 23 Gusht 1944 u çlirua Peshkopia dhe gjithë Dibra dhe kjo ditë u shpall dita e çlirimit të Dibrës.

Pas 30 Gushtit Brigada veprimi në luftimet kundra gjermanëve e bashkëpunëtorëve të tyre në Lumë, Kukës e Prizren...

Kukësi u çlirua më 18 Nëntor 1944 dhe së bashku me forcat e Brigadës V-të Sulmuese u çlirua Prizreni më 17 Nëntor 1944. Pas kësaj Brigadës u caktua detyra për asgjësimin e mbeturinave të mercenarëve dhe bashkëpunëtorëve me okupatorët nazifashistë në zonën Mirditë-Pukë.

Për të gjitha këto luftime e aksione të Brigadës është botuar Historiku i Brigadës së 18-të Sulmuese (të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare), 18 Gusht -25 Prill 1945, në vitin 2008.

Sipas kujtime të Hajri Hoxhës, -ish partizan dhe kuadër i kësaj brigade (ish-komisar i kompanisë së shtabit të Brigadës): "Pothuajse çdo natë Batalionet e Brigadës zinin pusi në istikamet e improvizuara rreth rrugës Prizren - Kukës, poshtë fshatit Bardhoc e të tjerë deri në afërsi të Kukësit që prisnim autokolonën gjermane të tërhiqeshin nga Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër. Po ashtu kishte javë që në ditë të caktuara për afro dy muaj batalionet me radhë ndërmerrnin aksione kundra forcave gjermane në qytetin e Kukësit. Këto jepnin rezultate në dëmtimet që u bënim si në njerëz e materiale autokolonave gjermane apo atyre të vendosura në qytet. Dhe ne të gjithë partizanët në këtë rast ruajmë pritjen që si para apo pas aksionit të fshatrave të Kukësit që nga Bica e Morina ndanin bukën e tyre me ne e çfarë kishin në shtëpi si groshën, dhallë e sidomos turshitë dimërore, sepse po të mos ishte kjo nga do t'i merrnim ne bukën etj. mos kishim magazinat me miell apo të tjerat? Jo, "magazinë" ishte zemra bujare e fshatarësisë si kudo në gjithë popullin shqiptar e sidomos të fshatarësisë edhe në të Dibrës-Krumës-



Kukësit-Pukës e Prizrenit".

Me çlirimin e Kukësit dhe Prizrenit u bënë ndryshime në udhëheqjen e Shtabit të Brigadës. Esat Ndreu u caktua me forcat e ndjekjes në Shkodër dhe Komandant erdhi Petrit Dume, ndërsa Komisar Hilmi Çausholli, sepse Miçua u caktua Komisar në një brigadë shqiptare në Maqedoni. Në këto ditë çlirimi të Kukësit Hajri Hoxha kujtonte ardhjen në Brigadën e XVII të 112 shokëve e shoqeve që kishin shpëtuar nga kampi nazist gjerman i Prishtinës, ku disa prej tyre u rreshtuan në këtë Brigadë, si i paharruari Kin Dushi që arriti të emërohet edhe Komandant Batalioni. Ai ka shkruar dhe botuar në libër vuajtjet dhe pushkatimet e 105 të rinjve shqiptarë në këtë kamp më 23 Tetor 1944. Po ashtu Kini ka vlerësuar trimërinë e gjithë shokëve që ishin pushkatuar e në mes tyre përmend heroizmin e ish-partizanëve të Batalionit të Dibrës Spiro Partku, Musa Agolli e të rinjve të tjerë dibranë si: Bilal Konxholli, Tasim Shehu, Hamza Shehu.

Pas çlirimit të Atdheut më 29 Nëntor 1944 Brigada e XVIII S, sipas Urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë

• **Dy batalione të Br. XVIII S, në bashkëveprim me forcat e Br. V S, më 2 shtator çliruan qytetin e Dibrës; më 21 shtator ajo goditi forcat reaksionare në rajonin e fortifikuar të Kalasë së Dodës, në Lumë, dhe i shpartalloi ato plotësisht; forca të Br. XVIII S morën pjesë në çlirimin e qytetit të Kërçovës, në këto luftime ra dëshmore edhe Hibe Palikuqi, Heroinë e Popullit; pas një vargu veprimesh luftarake kundër hitlerianëve në tërheqje, gjatë rrugës Prizren-Kukës-Pukë dhe në rrethet e Prizrenit, më 5.11. filloi goditjen kundër pushtuesve gjermanë në Kukës. Së bashku me Br. V S mori pjesë në çlirimin e Prizrenit më 16 nëntor, kurse më 17 nëntor ajo goditi e shpartalloi kolonën e ushtarëve armiq që drejtoheshin nga Prizreni në Kukës dhe në 18 nëntor çliroi qytetin e Kukësit**

NÇ, veprimi deri në Mars 1945 për asgjësimin e disa bandave mercenare të mbetura në zonat e Krumës, Mirditës dhe Pukës. Partizanët e saj kanë qëndruar për disa kohë në Fushë-Arrëz. Pas kësaj në udhëtimet Lumë, Dibër, Gollobordë, Librazhd, Gramsh, Përmet,

po sipas Urdhrit të Shtabit të Ushtrisë NÇ mbërritën në Gjirokastrë ku më 23 Prill 1945, efektivit i saj u bashkua dhe u rreshtua në një Brigadë me brigadën e 20-të Sulmuese. Gjatë periudhës 2-mujore efektivit i brigadës i shkaktoi dëme të konsiderueshme armikut.

## BRIGADA E 19-të S: Në një llogore kundër armiqve - shqiptarë e minoritarë

**B**rigada 19-të Sulmuese Partizane u krijua në Theolloq të Sarandës më 30 gusht të vitit 1944. Nga përbërja e partizanëve; shqiptarë e minoritarë dhe qëllimi i përbashkët, kjo është quajtur "Brigada e vëllazërimit", midis popullit shqiptar dhe minoritetit grek. Në Brigadën XIX u rreshtuan partizanë të batalioneve "Pandeli Boçari", Thoma Lulo, "Meteoti" (partizanë italianë) e "Thanas Ziko", me një efektiv rreth 800 vetë të organizuar në 3 batalione. Komanda e Brigadës diten e formimit të saj përbëhej nga këta kuadro: Komandant Andrea Nasi; komisar në fillim Vango Mitroqorji e me pas Thoma Xhixho, zv/komandant Mehmet Dusha; zv/komisar Lefter Kasneci etj.

Populli i minoritetit grek, duke pasur besim në platformën e Frontit NÇL të udhëhequr nga PKS H mori pjesë masive e aktive në LANÇ, luftoi për një jetë demokratike se do çlirohej nga robëria fashiste, nga regjimi antipopullor i Zogut, se do të siguronin lirinë e demokracinë dhe do t'i zgjidhnin drejt problemet e tij sociale. Dhe ky besim u justifikua mbas çlirimit.

Brigada që nga dita e parë e formimit e deri në fund, ka zhvilluar luftime të ashpra kundër nazistëve gjermanë dhe bashkëpunëtorëve të tyre ballistë e zervistë, duke u shkatërruar atyre humbje të mëdha. Të tilla qenë luftime në Konispol, Delvinë, Qafë Bot, Muzinë, Pec, Zminec, Stugar, Dhrrovjan, Libohovë, Qafë e Kiçokut e shumë luftime të tjera.

Të paharruar do të mbetet lufta frontale e 55 ditëve për mbrojtjen e Konispolit nga forcat gjermane. Luftime të ashpra kreu Brigada 19 mbi garnizonin e Delvinës ku ishin përqendruar rreth 500 gjermanë dhe 300 ballistë. Në momentet e para u zunë rob 50 ballistë. Por në këtë luftë ranë heroikisht 21 partizanë e kuadro dhe u plagosën 22 të tjerë. Në këto luftime gjermanët bënë barbarizma dhe vandalizma nga më të ashprat mbi trupat e vrarë.

Brigada 19-të S mori pjesë në çlirimin e qyteteve Delvinë, Sarandë, Gjirokastrë. Ajo u angazhua në veprimet

luftarake për goditjen e asgjësimin e garnizoneve të veçuara te pushtuesit gjerman në zonën përreth kreu goditje të njëpasnjëshme ndaj autokolonave gjermane në rrugët lëvizëse drejt veriut, si dhe shpartalloi bandat e xhandarmërisë dhe të ballisto-legalistëve në këtë zonë të bregdetit jugor të vendit.

Më 1 tetor 1944, me urdher të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë ANÇSH Brigada e 19-të kaloi në përbërje të Divizionit III së bashku me brigadat 12 dhe 14. Që nga 10 tetori i vitit 1944, iu ngarkua detyra e sigurimit të kufirit bregdetar Vlorë-Konispol dhe konsolidimit të pushtetit popullor. Miqësia që u gatua dhe u kalit në llogoret e luftës për liri u çimentua me gjakun e Polo Bezhanit, Llambro Nikës, Veliko Rexhës e Lejla Malos, Selfo Abedinit, Llambro Llambraqit, Petro Anagnostit, Urani Bari, Jani Papa, Theodor Mastora, Lefter Talo, Qirjako Dhroso e shume të tjerë që dhanë jetën në përpjekje me armiqtë. Në luftimet kundër nazistëve e bashkëpunëtorëve të tyre ranë heroikisht 73 partizanë e partizane dhe u plagosën 70 të tjerë ku mbetën invalidë një pjesë prej tyre.

Si për çdo njësi e brigadë partizane që u krijua gjatë LANÇ, edhe për Brigadën e 19-të Sulmuese, dita e formimit të saj mbetet një ngjarje e shënuar për popullin e zonës e rrethit ku ajo lindi, shqiptarë e minoritarë grekë, për Ushtrinë Nacionalçlirimtare dhe për historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në tërësi.

Është krijuar tashmë tradita e kthimit të kësaj date në një festë popullore, ku edhe një herë, shpaloset historia e lavdishme e LANÇ, ku kujtohen aksionet e luftërat e kësaj brigade kundër armiqve nazifashistë e bashkëpunëtorëve të tyre, kujtohen e nderohen me respekt ata që ranë në betejë për çlirimin e Shqipërisë, që mbetën uje të pashuar në panteonin e lavdisë, kujtohen gjithë luftëtarët e saj, sakrificat e panumërta të popullit. Dhe nga përkujtimi i kësaj date historike, përcillet mesazhi i madh: mos e prekni epopenë e madhe të LANÇ, të ruhet e të forcohet vëllazërimi mes popullit shqiptar e minoritetit grek, që u çelëkos në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare për çlirimin e Shqipërisë.



## REPORTAZH

Festa e një emri që u njoh jo vetëm në krahinën e Lumës apo Kukësit, por kudo në trojet shqiptare

# Turizmi malor dhe jehona e festës së Vilës

**Halil RAMA – Mjeshtër i Madh**

Jo pa qëllim, në javën e parë të qershorit, ndalesa e radhës e gazetares dhe moderatores së mirënjohur Alma Çupi për emisionin e saj televiziv “Histori Shqiptare” qe fshati Vilë i Kukësit. Sepse këtu është bërë traditë që çelja e sezonit turistik të bëhet pikërisht në ditën e Festës së Vilës, që tashmë është shndërruar në institucion. Një festë, që më shumë se promovim i resurseve turistike, njerëzore e historike, është bashkim i vlerave të elitës intelektuale të këtij fshati, përfaqësues të së cilës i gjen sot në institucione të rëndësishme shtetërore, dhe pse jo edhe sipërmarrës ndër më të suksesshmit, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Bruksel, Londër, Zyrë, Mynih.... Ndaj s’kishte si të mos e tërhiqte edhe kolegen tonë Alma Çupi, kjo festë tashmë tradicionale, për ta pasqyruar atë sa më denjësisht si “Histori shqiptare”. Është ky misioni fisnik për të promovuar traditat dhe vlerat e njerëzve punëtorë, banorë e ish banorë të këtij fshati në zermër të maleve, me histori të lvdishme.

Jehona dhe efekti i asaj feste të magjishme, që jo rastësisht organizohet me logon e Kompanisë “Billa” si organizatore kryesore dhe financuese e 92 përqind të shpenzimeve të saj, po përkthehet në bum turistësh nga e gjithë bota që vijnë për të vizituar e për të kaluar ditë të paharrueshme në këto vise të mrekullueshme dhe të bekuara nga Zoti me mrekullitë përrallore që Ai i ka falë fshatit Vilë. Dhe nuk është rastësi që në majën e lartë të Vilës së bukur të “Kepi i Ahut”, “Laku i Erës”, ku u organizua festa e këtij fshati, këto ditë të dëgjosh të fliten shumë gjuhë të botës! Turistë polakë, zviceranë, belgë e gjermanë, të mahnitur me bukuritë e rralla natyrore u gëzohen edhe ushqimeve bio tradicionale që ua ofrojnë bujarisht banorët e Vilës, tregues ky i zhvillimit të turizmit malor në këtë fshat të thellë të Kukësit.

Kjo edhe për faktin se, që festa të ishte sa më madhështore, Kompania Billa, në bashkëpunim me sipërmarrës tjerë nga Vila, bënë të mundur rehabilitimin e infrastrukturës rrugore nga Bushtrica deri në Lakun e Erës. Madje Kompania “Billa”, në respekt të këtij “orteku” të pandalshëm pjesëmarrësish në festë premtom se do ta sponsorizojë atë edhe në vitet e ardhshme, ndërkohë fton biznesmenët e Vilës të kontribuojnë për infrastrukturën dhe në projekte tjera zhvillimore për Vilën.

## RINGJALLJA E TRADITËS

Kepi i Ahut, Laku i Erës! Sa nostalgji zgjojnë këto toponime tek vilasit e larguar në mërgim, apo edhe në metropolin shqiptar. Dhe jo vetëm tek ata. Ish kryeministri Pandeli Majko, mes entuziamit të papërshekruar të mijëra pjesëmarrësve, do të shprehë se: “Ky është viti i dytë që nën protagonizmin e familjes Billa dhe bizneseve tjera nga ky fshat, mijëra banorë nga Vila dhe nga jashtë vendit mblidhen bashkë, duke e kthyer në një festë të gjithë komunitetit”. Parë nga ky këndvështrim, data 2 qershor 2024, ishte një ditë fantastike dhe që gëzoj pa masë çdo vilas, banorë që janë akoma aty në ato vise të mrekullueshme, po ashtu edhe bijtë e bijat e tyre të ardhur nga Tirana, Durrësi, Lezha, Shkodra e nga diaspora, dhe që u mblodhën me gëzimim më të madh, për të kujtuar dhe kaluar këtu momente të gëzueshme.

Nën moderimin mjeshtëror të Defrim Methasani – i njohur në gjithë vendin si dhe në hapësirën mbarëshqiptare, si ikonë e gazetarisë sportive



dhe dokumentarit televiziv, por dhe si organizator i talentuar i eventeve të tilla, festa do të niste me performimin e disa valleve nga valltarë të grupit famoz “Dardania”, nën ritmet e daulleve e curlave, për të vijuar me interpretimin mjeshtëror të “Elita 5”, Shkelzen Jetishit (Xenit), Shaqir Cervadikut, vëllezërve Sejdiu, Venera&Lind, Osman Hasa, Musa Dauti, Rami Jata, Fadil Jata, Gëzim Morina, Isuf Doçi dhe të humoristëve Behar mera e Genc Lleshi. Në këtë perlë të natyrës turistike, Defrimi do të improvizonte mjaft bukur një skenë gjigande nën freskinë e pyjeve, nga ku do të jehonte kënga e vallja lumjane. Më pas do të intervistonte dhjetëra personalitete dhe të përhapte siç di vetëm ai jehonën e mbresave të tyre. Kësisoj, kjo ditë feste mund të konsiderohet edhe si ringjallje e traditës me veprimtari nga më të larmishmet. Madje, nga këtu do ta merrte frymëzimin edhe poetja nga kjo zonë Lubi H Tota (vajza e Vajlës, Sulbie Han Tota, Barraç-Vilë, Kukës) për të shkruar esenë “Vila në festë”: “E bukur Festa në Vilën time, në Vilën e të gjithëve. Aty ku ka vetëm vlerë ai vend i bekuar nga vet Zoti i Madh. Vila ime për të disatën herë të brohoras në vatër me këngët e mia! Ty vend i bekuar që kurrë nuk do mundem të ta laj borxhin...”. Dhe nuk nguroj poetja Tota të falenderojë nga zemra të gjithë organizatorët që mundësuan këtë festë madhështore, të gjitha kompanitë që kanë djemt e Vilës në mbarë botën. Ndërsa më të moshuarit, të ngazëllyer nga atmosfera festive, e vlerësojnë festën e Vilës në aspektin e masivizimit dhe të ndikimit të saj në edukimin patriotik të brezave. Dhe kanë të drejtë, sepse përveç pjesëmarrjes masive dhe veprimtarive kulturore, festa pati ndikimin e saj edhe në evidentimin dhe promovimin e vlerave të historisë, të patriotëve e luftëtarëve të kësaj treve për liri e pavarësi kombëtare, të ngjarjeve e personaliteteve të LANÇ, traditës, arsimit e kulturës, që në këtë zonë, si askund tjetër kanë shkëlqim të rrallë.

## VILASIT, GJATË GJITHË HISTORISË E KANË THËNË DINJITËSHËM FJALËN E TYRE

Studjuesi i historisë Xhavit Lashi, autor i disa librave, që ishte në festën e Vilës si si bashkëkrahinar i vilasve, ende jeton me jehonën e asaj feste të paparë, dinjitoze, madhështore në kuptimin e plotë të fjalës, me

një pjesëmarrje masive, me një rregull për t’u admiruar. “Nga organizimi i kësaj feste duhet të marrin shembull të gjithë zonat e fshatrat që pretendojnë për festa të kësaj natyre. Në festën e tyre kishin ardhur banorë të Vilës nga të gjitha trojet ku banojnë dhe diaspora. Kishin ardhur nga Kosova me në krye nipin e patriotit të madh Hasan Prishtina, i nderuari Mehmet Prishtina. Kishin ardhur nga Shkodra, Dibra, Hasi, Tirana dhe nga të gjitha zonat e Kukësit. Kishin ardhur, ish - kryeministri Pandeli Majko sidhe përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore Kukës. Për gjashtë orë ushtoi Laku i Erës, ushtoi lugina e Drinit të Zi në kufijtë Lumë e Dibër nga muzika, nga këngët e vallet, nga përshëndetjet e brohoritjet”, shprehet i ngazëllyer Xhavit Lashi. Për të janë të paharruara takimet e përmalluara të pjesëmarrësve me njëri tjetrin, gjëmi-met e lodrave e meloditë e curleve, që herë - herë dukej sikur jepnin kushtrimin për luftë kundër pushtuesve si në kohën e bajraqeve. Si historiani e studiu, ai nenvizon faktin e padiskutueshëm se vilasit gjatë gjithë historisë e kanë thënë fjalën e tyre në luftë kundër serbëve e pushtuesve tjerë për mbrojtjen e trojeve të të parëve, në luftën e lvdishme Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin e veprave të mëdha energjitike kombëtare.. Ee kanë thënë me bujarinë dhe mikëpritjen e tyre. Në festat e gëzimit e tyre vilasit dijnë të gëzohen e argëtohen.

Xhavit Lashi, si dhe dhjetra personalitete që iu gëzuan kësaj feste madhështore nuk nguron të pohojë me plot gojën se kjo festë e ka një emër. Ideatori, inkurajuesi dhe pse jo edhe organizatori i saj është Shefqet Billa, ish - mësues e drejtor shkollë në këtë zonë dhe ish drejtues i suksesshëm e i respektuar i pushtetit vendor. Në festën e Vilës ai ishte një i vilase në mes të vilasve duke u përshëndetur, duke biseduar e duke gezuar bashkë me ta.

“Shefqet Billën e karakterizon thjeshtësia. Çiltërsia, sinqeriteti, mirësia e dashuria ndaj të gjithë atyre që e rrethojnë. Suksesin e tij e mbeshtet të puna në grup. Ai është shembull i ndjenjes së humanizmit njerëzor, duke ndihmuar njerëzit në nevojë. Te Shefqet Billa gjen modelin në trajtimin e problemeve e ngjarjeve me objektivitet, me vërtetësi e në mënyrë reale”, - thotë Xh.Lashi. E ndërsa ai evidenton këto cilësi të tij, Rramiz Hasa kujton kohën kur kacnecët e pushtetit monist donin t’i prishnin shtëpinë e saponduar, ndërsa Shefqet Billa si ish - kryetar i këshillit popullor të



fshatit, vë veton për të mos ja çuar dëm bashkëfshatarit të tij djersën e derdhur për të patur një shtëpi si gjithë të tjerët. Nuk e harron ish - mësues Shefqetin edhe djali i vetëm i Rramizit, Urim Hasa, menaxher i një lokali liksoz në Londër. I brengosur që këtë vit, për arsye pune nuk mundi të vinte në festë, Urimi thotë se për vitin tjetër që tani i ka rezervuar biletat e avionit.

Fjalë zemre thonë të gjithë ata që shijuan bukurinë dhe magjinë e kësaj feste edhe për bashkëorganizuesin e saj Ideal Billa, që siç ka emrin, ka idealizuar progresin e Vilës, të familjes, të kompanive e të shoqërisë së tij.

## FESTA E VILËS, NJË BASHKËSI VLERASH


Festa e Vilës ishte më shumë se një ngjarje, ishte një bashkësi vlerash, manifestim i solidaritetit njerëzor. Ndaj dhe jehona e saj vazhdon të parhapet anekand Shqipërisë, si dhe në hapësirën mbarëshqiptare në botë. Moderatori i saj, Mjeshtër i Madh Defrim Methasani, edhe pse kanë kaluar disa ditë, nuk mund të heshtë përballë një madhështie dhe të mos shprehë të paktën një falenderim, mirënjohje por dhe vlerësim për festën e Vilës dhe organizatorët e saj. “Ata më besuan dhe jam i lumtur që ia dolëm në mënyrën më të mirë të mundëshme, duke tejkualuar çdo pritshmëri. Mijra njerëz u ngjiten në atë vend të bekuar nga Zoti me natyrën piktoreske dhe njerëzit e mirë të tij, në ‘Laku e Erës’, pika më e lartë ku të dukej se aty ‘toka takohet me qiellin’... Fjalë zemre për burrin e madh e mikun e mirë Shefqet Billa, për komisionin organizator me kryetar njeriun super korrekt Ideal Billa, për shokun e mikun po special që inicioi edhe përzgjedhjen time si moderator i festës Arben Jata, për artistët e mrekullueshëm që performuan në atë skenë natyrale mes malesh e lëndinash të pafund dhe për secilin që u bë pjesë e nadhështisë së një feste të një fshati me kaq tradita në Kukës dhe shqiptari, si Vila. Mirënjohje 5 fiseve të një fshati me kaq shumë personalitete në çdo fushë, Billa, Jata, Dragjoshi, Tota dhe Hasa dhe i falenderoj për gjithë respektin që treguan ndaj meje. Edhe pse zgjati mbi 5 orë, gjithçka na u duk sikur zgjati 5 minuta...”, shprehet Z. Methasani. Për ikonën e gazetarisë sportive dhe të moderimit të eventeve të rëndësishme, jo vetëm në Tiranë, por edhe në diasporë, festa e Vilës ishte një tjetër besim i dhënë, kënaqësi, por edhe përgjegjësi, si moderator i saj. Kjo edhe për faktin se do të moderonte festën e një emri që u njoh jo vetëm në krahinën e Lumës apo Kukësit, por kudo në trojet shqiptare. Sepse Festa mblodhi mijra njerëz paraditen e së dielës së 2 qershorit, në një vend ku turizmi dhe arti bëhen bashkë.



## SPECIALE

25 vjetori i përfundimit të luftës në Kosovë dhe i përfundimit të ndërhyrjes së forcave të NATO-s

# KOSOVA MES LUFTËS DHE PAQES



BASHKIM HISARI

WWW.FJALAEKURE.COM  
REVISTA: "ALBANIAN POST" LONDËR

Bashkim Hisari

**Bashkim Hisari**  
**Nënryetar i Org.Veteranëve të**  
**LANÇ të Kosovës**

Banorët e fshatrave Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël, nga viti në vit dhe nga dekada në dekadë jetën e vazhdojnë pa u ndalur, të pasionuar në punën e tyre të bereqetshme bujqësore ndonëse, me zemra të thyera, me vuajtje shpirtore dhe dhembje të përhershme. Mbase të kaluarën e hidhur e bartin në shpirt. Por, krushjanët e që të dy këtyre vendbanimeve që shtrihen në të djathtë të rrugës Prizren-Gjakovë, jetojnë me krenarinë se themelet e lirisë së Atdheut i ujitën me gjakun e më të dashurve, të cilët i kujtojnë me nderim të veçantë dhe nuk do ti harrojnë kurrë.

Në këto dy fshtara, më 25 e 26 mars të vitit 1999, forcat policore kriminale serbe kryen masakër duke vrarë e zhdukur 357 civilë shqiptarë, përfshirë 7 fëmijë dhe 5 gra. Në mesin e tyre ishte edhe Ukshin Hoti, intelektual, atdhetari dhe veprimtari i shquar i çështjes kombëtare në Kosovë. Në Krushë të Madhe u vranë 243 persona, në Krushë të Vogël u pushkatuan 114 të tjerë, trupat e të cilëve më pas u dogjën dhe sipas dëshmitarëve okularë, u hodhën me ekskavator në lumin Drini i Bardhë. Trupat e disa dhjetëra viktimave nuk janë gjetur ende. Nuk dihet fati i tyre ndonëse janë në listën e personave të zhdukur me dhunë. Dysohet se trupat e tyre kanë përfunduar në varreza masive në të gjithë Serbinë.

Nga takimet dhe bashkëbisedimi me të mbijetuarit që pothuaj çdo ditë qëndrojnë tek Kompleksi i ngritur në shenjë përkujtimi të viktimave të masakrës në këto fshatra, njeriu nxjerr përfundime që lënë të kuptohet se të gjithë këta jetojnë me shpresën se një ditë do ti gjejnë të dashurit, bijtë, baballarët, vëllezërit dhe miqtë pa të cilët, jeta e tyre është e zymtë.

Në fytyrat e molisura të tyre pranë varrezave, ndjehet malli, dhimbja dhe pikëllimi. Edhe në zërin e tyre, vetëdijen e mprehtë dhe në presionin e emocionave shihet shpresa se një ditë do ti gjejnë më të dashurit e tyre dhe ndjenjat i shprehin me fjalët që rrëqethin: "Të gjeshe një djal, baba, vëlla apo bashkëshort të zhdukur, do të thotë të nxjerrësh të vdekurit nga anonimiteti në të cilin i kanë shtyrë vrasësit e tyre". Theksojnë se për ta, krimet e

Rreth 1600 persona konsiderohen ende të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Ndonëse çështja e hapjes së arkivave për të pagjeturit është ngritur në kuadër të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve, ende nuk ka lëvizje që do të sjell shpresë të re. Nëse Serbia do t'i hapte ato arkiva, do të duhej të përballej me faktin se është përgjegjëse për shumë krime që kanë ndodhur në Kosovë dhe në trojet tjera të ish Jugosllavisë nën ombrellën e ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve të tyre



Krushë e Madhe

kryera nuk do të vjetërohen kurrë dhe se nuk do të ndalen për të zbardhur fatin e të zhdukurve dhe për të kërkuar që autorët e krimeve të vihen para drejtësisë.

Kjo është tabloja e parë dhe atmosfera e rrethanave të jetës në fshatrat Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël, në 25 vjetorin e përfundimit të luftës në Kosovë dhe të përfundimit të ndërhyrjes së forcave ndërkombëtare të NATO-s.

## SERBIA E SOTME ZYRTARE SI AJO E VITEVE '90-të

Pas 25 vjetëve në politikën e Serbisë nuk ka ndryshime të dukshme. Serbia e sotme të kujton atë të viteve nëntëdhjetë. Etnonacionalizmi, kleronacionalizmi dhe politika e urrejtjes janë narrativa dominuese që përhapin idetë e tyre helmuese. Qeveria vendos një politikë që kryesisht është e dhunshme. Në establishmentin e qeverisjes janë trashëgimtarë të një politike që ka bërë shumë të këqija. Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq ishte ministër i propagandës në pushtetin e Slobodan Millosheviqit dhe pasardhës i kriminelit të luftës, Vojislav Sheshelj.

Në postin e zëvendës kryeministrit dhe ministrit për punë të Brendëshme është Ivica Daçiç, dikur zëdhënës i kriminelit Millosheviç. Sipas shkrimeve në media të pavarura, ish-drejtor i Agjencisë së Intelgjencës dhe Sigurisë, Aleksandar Vulin, tani nënkryetar në Qeverinë e Serbisë, ishte deputet i Mirjana Markoviqit, gruas së Millosheviqit dhe oficer ndërlidhës me Rusinë, i përfshirë në krimin e organizuar transnacional, në operacione të paligjeshme narkotike dhe në aktivitete korruptive që avancojnë axhendat e tyre politike dhe interesat personale në dëm të paqes dhe stabilitetit. Bozhur Joviçiq, gjyshi nga nëna i Kryetares së Kuvendit të Serbisë Ana Brnabië, ka qenë çetnik, bashkëpunëtor i fashistëve bullgarë dhe një nga xhelatët më të mëdhenj që vrau qindra njerëz.

Ata nuk lejojnë qasje në të gjitha dokumentet në posedim të institucioneve të tyre, nuk tregojnë gatishmëri për hapjen e arkivave ushtarake dhe policore që mund të ndihmonin shumë në ndriçimin e fatit të shqiptarëve të zhdukur me dhunë.

Rreth 1600 persona konsiderohen ende të zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Ndonëse çështja e hapjes së arkivave për të pagjeturit është ngritur



në kuadër të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve, ende nuk ka lëvizje që do të sjell shpresë të re. Nëse Serbia do t'i hapte ato arkiva, do të duhej të përballej me faktin se është përgjegjëse për shumë krime që kanë ndodhur në Kosovë dhe në trojet tjera të ish Jugosllavisë nën ombrellën e ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve të tyre.

## NË SERBI EKZISTOJNË LIDHJET E FORTA MES STRUKTURAVE POLITIKE DHE KRIMINALE

Pushteti rehabiliton kriminelët e luftës dhe nuk bën asgjë që të tillët të japin llogari para drejtësisë. Përkundërazi, ata kanë ndikim të rëndësishëm në ngjarjet politike. Me militantët e Partisë Progresiste Serbe të Aleksandar Vuçiqit kanë pushtuar dhe vendosur sistemin e tyre në drejtësi, financa, univeristete, organet rregullatore, komisione zgjedhore, ndikojnë në politikën kadrovike, mbikëqyrin shërbimet e sigurisë etj. Bukvalisht, kontrollojnë çdo segment të shoqërisë dhe tregojnë arrogancë, pamaturitë, ndjenjen se kanë sundimin politik pa kufi dhe nuk mbajnë përgjegjësi për çfardo parregullsi që bëjnë.

Beogradi dhe Vuçiqi përgatisin opinionin e tyre për të kryer veprime kriminale. Përhapin lajme të rrejshme. Me retorikën luftënxitëse pa etikë e moral, fyejnë shqiptarët dhe kërcenojnë me luftë. Hapur sulmojnë individë dhe organizata që duan drejtësi, demokraci dhe integritet evroatlantike. Në këtë drejtim, regjimi i Vuçiqit, prej 12 vitesh krijon konfuzione dhe kërcënon paqen në rajon. Manipulon me serbët lokale, të cilët janë bërë pengje të politikës serbomadhe në Kosovë. Në enklavat serbe përhapin urrejtje, frikë e intolerancë, prekin dhimbjet dhe plagët e tyre. Informojnë se në çfarë lartësie fluturojnë dronët "Bajraktar" të Ushtrisë së Kosovës dhe bëjnë premtime të rreme se ushtria serbe do të kthehet në Kosovë, se Kosova është Serbi dhe krekosen me baza ushtarake të ndërtaura rreth kufirit me Kosovën, ku serbët kryejnë stërvitje që, pas

sulmeve në Banjëskë, le të kuptohet se planifikojnë të aneksojnë veriun e Kosovës. Asgjë nuk bëjnë për uljen e tensioneve dhe për zbatimin e marrëveshjeve për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Tensionet në veri të Kosovës cilësohen si rrezik kryesor për sigurinë në rajon, ku nuk përjashtohet mundësia e përdorimit të forcës për zgjidhjen e çështjeve.

Autoritetet në Kosovë paralajmërojnë se kërcimet e Serbisë ndaj sigurisë së Kosovës janë në rritje dhe se ato mund të rrezikojnë paqen. Kryeministri i Kosovës Albin Kurti, ndër të tjera thotë: "Serbia është angazhuar në luftë hibride dhe po zhvillon trajnime ushtarake në bazat që i ka pranë kufirit me Kosovën".

Sipas Presidentes së Kosovës Vjosa Osmani, Serbia po përpiqet të luajë "lojërat e presidentit rus, Putin, duke hapur një front të ri ndaj përdorimit". Ndërkaq, kryetari i Kuvendit të Kosovës Glauk Konjufca thekson se: "në Serbi një grup prej qindra ushtarësh po përgatitet për sulm të mundshëm ndaj Kosovës". Edhe disidenti më i njohur serb Boban Bogdanoviç, paralajmëron një skenar të keq në Kosovë. Sipas tij, prapa kësaj qëndron presidentit serb Vuçiq. "Kam frikë se do të ketë gjakderdhje. Lufta është e vetmja rrugëdalje për Vuçiqin. Për të qëndruar në pushtet ai nuk e ndal dot veten, duhet të shkaktojë konflikte".

Mirëpo, Kosova është përcaktuar qartë për paqe, barazi, demokraci dhe për integritet evroatlantike. Dallimet, konfrontimet, interesat dhe mospajtimet brenda partive politike, fare nuk paraqesin pengesë për të qenë bashkë për çështjet nacionale dhe shtetin e Kosovës.

Që kur Kosova fitoi pavarësinë, institucionet e saja të sigurisë janë vigjilente, koordinojnë me aleatët ndërkombëtarë dhe janë në gjendje të përballen me çka do që vijë nga Serbia. Ndaj, mjegullat e kërcënimeve për luftë dhe të ëndrrave për një Serbi të Madhe janë zhdukur në erë. Shqiptarët tanimë kanë mësuar se çfarë është liria dhe do të bëjnë çmos për ta mbrojtur atë.

## DOSSIER

# 75 vjet më parë - Si u organizua rezistenca ndaj agresionit grek të 2 gushtit 1949

• *Kush ishte centralisti i postës kufitare "Guri" të Kapshticës që e bindi komandantin e Postës kufitare të Vidohovës për të hapur zjarr, me iniciativë, pa urdhër nga lart, në mbrojtje të kufijve të atdheut nga agresioni i monarko-fashistëve grekë më 2 gusht 1949?*

**Halil RAMA – Mjeshtër i Madh**

## NGJARJA E 2 GUSHTIT 1949 NË VIDOHOVË GREQIA SULMOI PAS 8 MUJAJ PROVOKACIONE USHTARAKE NË KUFITARE

Dokumentat arkivore, por edhe dëshmitarë okularë vërtetojnë se, shtatëdhjetëepesë vjet më parë, në sulmin e 2 gushtit 1949, grekët përdorën kundër Shqipërisë ushtrinë me topa, avionë, ushtri tokësore e gjithçka që përdor çdo ushtri që synon të pushtoj një vend tjetër. Ushtria shqiptare iu kundërpërgjigj sulmit pushtues grek, me luftë të armatosur, në mbrojtje të kufijve e trojeve që u sulmuan. Ishte një luftë e përmasave dramatike. Ndërsa Greqia vërsuli drejt Shqipërisë mbi 70 mijë forca të armatosura, mbi 50 avionë, 80 tanke dhe një skalion artilerie me afro 400 gjuajtës, kryesisht topa, shteti shqiptar mobilizoi dhe futi në luftën mbrojtëse 10 mijë ushtarë, ndërkohë që po mbante në gatishmëri edhe 30 mijë trupa të tjerë pranë zonës së sulmuar.

Kufiri shqiptar ishte bërë prej vitesh arenë e provokacioneve të shkaktuar nga shtetet fqinje, për qëllimet e tyre agresive apo pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë. Viti 1949 është i veçantë. Vetëm gjatë këtij viti në kufijtë shqiptare u bënë gjithsej 747 provokacione të llojeve të ndryshme (tokësore, ajrore e detare), nga të cilët 612 në kufirin me Greqinë (303 tokësore, 299 ajrore e 10 detare); 130 në kufirin me Jugosllavinë (57 tokësore, 69 ajrore e 4 detare) dhe 5 (ajrore) në sektorët bregdetare me Italinë. Të gjitha këto provokacione, u paraprinë edhe nga një propogandë e shfrenuar që bënin vendet fqinje kundër Shqipërisë, veçanërisht në sektorët e Jugut. Ata jo vetëm hidhnin në territorin shqiptar libra, broshura e gazeta me thirrje kundër pushtetit popullor në Shqipëri, por arritën deri atje sa të fabrikonin dhe përhapnin trillime, sipas të cilave rreth kufirit shqiptar ishin krijuar baza, prej nga ku furnizoheshin partizanët grekë në luftën kundër andarteve (forcave të ushtrisë demokratike greke). Robërit grekë të kapur nga Forcat e Kufirit Shqiptar, pohonin gjithashtu edhe përgatitjen psikologjike që u bëhej ushtarëve grekë për një sulm të afërt ndaj Shqipërisë.

Provokacionet greke në kufirin me Shqipërinë, arritën kulmin e tyre më datë 2 gusht 1949, kur forcat e tyre ushtarake organizuan dhe kryen sulmin e armatosur kundër rojeve kufitare shqiptare në sektorin e Devollit, duke shkelur kështu edhe integritetin territorial të RPSH-së. "Veprime të tilla na kujtojnë metodat e nazistëve gjermanë dhe të fashistëve që krijojnë incidente në kufijtë me fqinjët e tyre me qëllim presioni e kërcënimi, për të krijuar pasiguri e armiqësi në mes të popujve ose për t'u hapur rrugë veprimeve më të gjera agresive", shkruante ndër të tjera në kryeartikull, gazeta "Zëri i Popullit" në atë kohë, duke u prononcuar forcërisht për ngjarjet e 2 gushtit, në kufirin shqiptaro-grek.

## HEROI I REZISTENCËS NDAJ MONARKO-FASHISTËVE GREKË

Më 2 gusht 1949, do të ishte një centralist i thjeshtë nga Çidhna e Dibrës urdhëruesi i hapjes së zjarrit ndaj provokatorëve monarkofashistë grekë në kufirin shqiptar të Kapshticës. Adem Hoxha, centralist i postës kufitare në Kapshticë të Devollit, kishte radhën e shërbimit të gatishmërisë luftarake në natën e datës 1 (një) gusht duke u gdhirë 2 (dy) gusht i vitit 1949, kur rreth orës 02:00 të mëngjesit të datës 2 gusht 1949, ra zilja e telefonit.

Mori receptorin dhe nga ana tjetër, personi që i fliste, u prezantua se ishte komandanti i Postës kufitare të Vidohovës.

Për momentin emri i tij nuk më kujtohet, – tregonte Ademi, – por mbaj mend se ai ishte një djalë i ri rreth të njëzet e dy-tre vjetëve, të cilit, sapo kishin filluar t'i dirsin mustaqet. (Sipas bashkëkohësve, ai duhet të ketë qenë Memo Nexhipi Bejko, – pak çaste para se të binte dëshmor, i cili më pas është shpallur "Hero i Popullit").

Kur Komandanti i postës së Vidohovës, z.Memo Nexhipi Bejko i ka kërkuar centralistit Hoxha që ta lidhte me komandantin e regjimentit, Ademi, iu përgjigj se "Komandanti i regjimentit në këtë orë është në shtrat, duke fjetur në shtëpinë e tij, në Korçë. Ai nuk ka telefon në shtëpi."

Më pas komandant Memoja i ka kërkuar kufitarit nga Dibra që ta lidhte me Ministrinë e Mbrojtjes, por sërish ka marrë përgjigje refuzuese:

"Përderisa nuk mundem me të lidhur me Korçën, si mundem me të lidhur me Ministrinë në Tiranë?! Ne nuk kemi lidhje me radio, por vetëm një central të thjeshtë, me tel!", -i është përgjigjur Adem Hoxha. Dhe në kushtet kur forcat greke kishin shkelur 500 metra në territorin tonë kufitar, komandant Memoja, i zënë ngushtë i ka kërkuar një mendje centralistit nga Dibra se si duhej të vepronte.

-Zjarr!, – i është përgjigjur Ademi.

-Si të hap zjarr?! Me urdhër të kujt të hap zjarr?! – i tha komandanti i postës së Vidohovës.

-Me urdhërin tim! – i është përgjigjur rrufeshëm kufitar Ademi.

-Si me urdhërin tënd?! – ka vijuar komandanti?!!

-Po të them: Me urdhërin tim! Kur forcat greke do të të vijnë te posta, ti a do t'u japësh cigare e duhan dhe t'ua nderzish me shkrepse me dorë në zemër?! Zjarr mbi agresorët, se vetëm kështu mbrohet Atdheu!

Vetëm këto ishin fjalët e fundit që këmbyen komandant Memoja dhe centralisti Adem Hoxha ndërmjet tyre, në mëngjesin e 2 gushtit 1949, para se të fillonte lufta mbrojtëse në Vidohovë kundër agresionit të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Pra, e thënë ndryshe, urdhërin luftarak për fillimin e zjarrit të parë, të pushkëve të para në Vidohovë me 2 gusht 1949 e ka dhënë, me iniciativën e vet, një ushtar i thjeshtë dibran, Adem Islam Hoxha, ish-centralist i postës kufitare të Kapshticë-Vishocës. Më saktë, me atë arsyetim logjik të pjekur, tepër bindës, në ato rrethana të jashtëzakonshme bindi me të drejtë komandantin e Postës së Vidohovës për të hapur zjarr mbrojtës kundër agresionit të monarkofashistëve grekë, më 2 gusht 1949, në atë situatë të nxehtë luftarake.

Një arsyetim i tillë, si ai i Adem Hoxhës, është tepër bindës dhe i drejtë edhe tani, pas 75 VITESH, në kohë paqeje dhe në një situatë tjetër marrëdhëniesh krejt të ndryshme nga ajo e asaj kohe, kur Shqipëria dhe Greqia janë të dyja shtete anëtare të NATO-s (ndonëse Greqia vazhdon të bajë ende në fuqi Ligjin absurd të Luftës me Shqipërinë).

Nuk mund të kishte asnjë zgjidhje tjetër, përveç asaj të Adem Hoxhës, të mëngjesit të 2 gushtit 1949: për të hapur zjarr mbi agresorin.

Kjo është një e vërtetë historike, ndonëse e pashkruar ndokund, ashtu si shumë të vërteta të tjera të pashkruara të historisë së popullit shqiptar, e rrëfyer qartë nga protagonistin e kësaj ngjarjeje në vitin 1993, kur ishte në moshën 76 vjeçare.



Kufitari Adem Hoxha, Kapshticë, gusht 1949

## ÇFARË SHKRUANTE "ZËRI I POPULLIT" MË 6 SHTATOR 1949

Akti heroik i çidhnaikut Adem Hoxha jepet fare qartë, qoftë dhe nga një fragment i reportazhit të të dërguarit të posaçëm të "Zërit të Popullit", Dhimitër Tona, me titull: "Në piramidën 33, në sektorin e Bilishtit", botuar më 6 shtator 1949. Ndër të tjera në të shkruhet: "...Centralisti ndërlihdës, Adem Islam Hoxha nga Çidhna e Poshtëme i Dibrës, në mes mijëra predhash të artilerisë armike, ku s'mbeti pëllëmbë toke pa u qëlluar, ka kryer me heroizëm detyrën e tij: tri herë natën u këput linja, por të tri herët ai e lidhi përmes zjarrit të artilerisë dhe breshërit të plumbave të mitralozit. Në luftën NCÇI-thotë ushtari Adem Hoxha, i dekoruar me Medaljen e Trimërisë, - nuk pata fat të luftoja kundër armikut, tashti jam edhe unë kryelartë midis shokëve të mij se kam luftuar ashtu si vëllezërit e mij dje për çlirimin e Atdheut; sot unë luftova për mbrojtjen e tij nga monarkofashistët grekë që duan ta skllavërojnë popullin tonë dhe të sjellin në fuqi armiqtë tanë....".

## KUSH ISHTE ADEM HOXHA?

Njëqinte shtatë vjet më parë, më 9 janar 1917, në Çidhna të Dibrës lindi Adem Islam Hoxha, emri i të cilit hyri në historinë e kombit për aktin e pashembullt heroik në rezistencën ndaj monarkofashistëve grekë, gjatë provokacioneve të njohura të gushtit të '49. I mbetur jetim që 6 muash, pasi babai Islami dhe nëna, Lihja i vdiqën nga epidemia e tifos e vitit 1917, Ademi do të rritej dhe edukohej nga gjyshi i tij, Abdurrahmani (Hoxhë Kuta). I njohur me titullin "Hoxha i 12 mijëve" në Shehër të Thatë, njëri ndër udhëheqësit popullor për organizimin e rezistencës të krahinës të Çidhnës e të mbarë Dibrës kundër pushtuesve serbo-sllavë në fillim të shekullit XX (gjatë viteve 1912-1920), do të përkujdesej që këto virtyte t'i mishëronte edhe nipi, Ademi. Edukimin e parë atdhetar me dashurinë për atdhe dhe urrejtjen kundër armiqve pushtues e mori qysh në moshën 3-vjeçare, në vitin 1920, në kohën e pushtimit serb për të shpëtuar nga masakrat e pushtuesve, kur për tre muaj rresht u strehua në një shpellë në Gjalica të Çidhnës, në një kohë që pjesa tjetër e popullsisë së Dibrës u shpërngul drejt Tiranës, ashtu si në vitin 1913. Që nga ajo kohë, dhe sot e kësaj ditë, ajo quhet "Shpella e Hoxhës". Në vitin 1940 për veprimtari atdhetar antifashist, u burgos nga pushtuesit italianë dhe u internua më pas në kampin e përqendrimit nazifashist në Ventotene të Italisë ku u dënua me 2 vjet dhe qëndroi nga janari

## DOSSIER

• **Historia e centralistit Adem Islam Hoxha që urdhëroi hapjen e zjarrit në kundërpërgjigje të sulmit të agresorëve grek**

(Vijon nga faqja 10)

1940 deri në dhjetor 1941. Ky fakt vërtetohet edhe nga regjistri që gjendet pranë Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, Tiranë në faqen nr.3 të cilit me nr.rendor 21, z.Adem Hoxha (atëherë Kuta) figuron të ketë qenë i internuar prej nazifashistëve në kampin e përqendrimit në Ventotene, Itali, prej datës 11.02.1940 deri në dhjetor 1941, duke mos u përfshirë këtu koha e paraburgimit në Peshkopi, para transferimit në Itali dhe ajo e qëndrimit prej 24 ditësh të tjera në burgun e Barit në Itali.

Në kampin nazifashist të Ventotenes Ademi u njoh dhe u miqësua me atdhetarë të tillë, udhëheqës të rezistencës shqiptare kundër pushtuesve nazifashistë, si Nazmi Rushiti, Sadik Bektashi, Ibrahim Dervishi, Abdyl Këllezi, Zef Mala etj. apo dhe me nacionalistët Safet Butka, Abas Ermeni, Prof.Isuf Luzaj etj. Shoqëria dhe miqësia e tij me figura të tilla, ia rriti Ademit eksperiencën dhe pjekurinë politike.

Në dhjetor 1947, Adem Hoxha, nga Çidhna, Dibër, kur i kishte kaluar 30 vjeç, u mobilizua për të kryer shërbimin ushtarak të detyruar në Qarkun e Korçës, (gjatë viteve 1947-1950), prej të cilëve, dy vjetët e fundit në kufi, në Bilisht. Pra, në kohën kur dha urdhërin luftarak për të hapur zjarr mbi forcat agresive të monarkofashistëve grekë, Ademi i kishte të gjitha cilësitë dhe aftësitë si dhe ngritjen ideo politike dhe përgatitjen ushtarake për të komanduar e për të dhënë një urdhër luftarak me peshë të tillë që ishte vendimtar për fatet e atdheut.

Adem Hoxha, i biri i Islamit dhe i Lihes (1917-1993), nga Çidhna, Dibër, luftëtari i vijës së parë të frontit të luftimeve për mbrojtjen e kufijve të Atdheut tonë nga provokacionet e monarkofashistëve grekë në gusht të vitit 1949, ishte tepër modest, ndaj nuk ka lënë kujtime të shkruara, por vetëm këto rrëfime gojore që nuk na shqiten lehtë nga kujtesa.

Për aktin heroik ish centralisti dibran i postës kufitare "Guri" në Kapshticë të Devollit, Adem Hoxha është dekoruar me "Medaljen e Trimërisë". Kjo vërtetohet me certifikatën e lëshuar nga ish Presidiumi i Kuvendit Popullor të RSH me nr.6749 dhe nr.i Dekretit 911, datë 23 gusht 1949 që mban nënshkrimin e ish-Presidentit Dr.Omer Nishani dhe të ish-Sekretarit Sami Baholli. Në këtë Medalje është shënuar ky motivacion: "Gjatë luftimeve për mbrojtjen e kufijve t'Atdheut në sektorin e Trestenikut nga agresioni i monarko-fashistave grekë, është dalluar për trimëri, vendosmëri e besnikëri". Kjo certifikatë është një argument tjetër më shumë që vërteton katërcipërisht se Adem Hoxha ka qenë i saktë në rrëfimet e tij të para dy dekadave. Përpos kësaj, autoriteti i tij i padiskutueshëm në jetën civile, kur ka shërbyer mbi 60 vjet si imam, drejtues fetar dhe shoqëror, nuk lë asnjë shteg për asnjë fije dyshimi mbi të vërtetën e tregimeve të tij për organizimin e rezistencës ndaj provokacioneve të monarkofashistëve grekë të 2 gushtit 1949.

Si bashkëbisedues i para dy dekadave ruaj në memorien episode të rrëfyera mjeshtërisht nga Ademi për Provokacionet e 2 gushtit 1949. Shpesh herë ai thoshte se jetën në atë luftë ia ka shpëtuar ish- Komandanti i Regjimentit, z.Baki Starja. "Gjatë luftimeve unë kisha detyrë që të mbaja ndërlihdjen me central fushor, të lëvizshëm, atje ku zhvilloheshin luftimet. Pozicioni i centralit nuk mund të ndryshohej pa urdhërin e komandantit. Në një moment të caktuar, gjatë luftimeve ra një predhë murtaje e armikut vetëm disa metra larg, ngjitur me pozicionin ku unë kisha vendosur centralin. Pranë meje ndodhej edhe z.Baki Starja, më vonë gjeneral. Fill pas atij momenti, komandant Baku më urdhëroi:



Adem Hoxha, Ventotene, qershor 1940



Adem Hoxha dhe Arif Pitarka – gusht 1949

## 75 vjet më parë - Si u organizua rezistenca ndaj agresionit grek të 2 gushtit 1949

Adem, shpejt spostoje centralin mu në gropën që hapi predha e murtajes së armikut. Sapo unë instalova aparaturnë e telefonit në vendin e caktuar, vetëm disa sekonda më pas, ra predha e murtajes së armikut, pikërisht në vendin ku unë pata më parë pozicionin e centralit. Po të mos kisha ndërruar pozicionin e instalimit të centralit, unë do të isha vlarë në atë luftë," – tregonte Ademi, duke shprehur njëherësh edhe respektin dhe mirënjohjen për Gjeneral Baki Staren që ka qenë oficer madhor në Provokacionet e gushtit 1949. Gjatë një takimi të rastësishëm, gjenerali në pension, Baki Starja, jo vetëm ma konfirmoi plotësisht atë çka treguam më sipër, lidhur me spostimin e centralit fushor, por pasi më shprehu edhe konsideratën e lartë dhe kujtimet që ruante për ish-ushtarin e tij 32-vjeçar, nga Dibra, bashkëmoshatarin Adem Hoxhën, më tregoi edhe arsyen e dhënies së atij urdhëri, d.m.th. eksperiencën e tij luftarake.

### RRËFIMI I GJENERAL BAKI STARJES

Gjeneral Baki Starja që kishte kryer shërbimin e detyruar ushtarak në kohën e luftës Italo-Greke, kujton gjithashtu kohën kur ka qenë i mobilizuar në repartin e ushtrisë shqiptare dhe shoqërinë me bashkëushtarin Vesel Bushi (Spata) nga Bllaçja e Peshkopisë nga. Nga përvoja e asaj lufte ata kishin mësuar se ushtria greke, artilierët i kishte ushtarë të karrierës me rrogë dhe jo rekrutë të shërbimit të zakonshëm të detyruar. "Artilierët grekë, si profesionistë të kualifikuar, predhat e artilerisë nuk i shpërdoronin, prandaj ata nuk shenjnin me gjuajtje dy herë në të njëjtin vend, por për çdo qitje e lëviznin gradimin e shenjimit, për të mos rënë dy predha radhazi në të njëjtin vend. Duke ditur këtë eksperiencë, unë e urdhërova Ademin që menjëherë të sposton-

te instalimin e aparaturnës së centralit pikërisht në vendin kur ra predha e mëparshme, pasi e dija se aty ishim të sigurtë nga goditjet e armikut",-tregon gjeneral Starja. Ndërsa centralisti Adem Hoxha, me krenari pohonte faktin që të gjithë ushtarët dibranë që morën pjesë në luftimet kundër provokacioneve të gushtit, shkëlqyen, duke u dalluar ndër të tjerët. Kjo sipas tij edhe për faktin se asnjë ushtar dibran nuk u largua nga pozicioni i luftimeve, ku e kishte caktuar komanda, por të gjithë ata, në përfundim të luftimeve u gjetën në vijën e parë të frontit. Kjo, ndoshta, u bë shkak që më pas dibranët të shiheshin me një sy tjetër më të mirë, nga komanda, ndryshe nga më parë, pasi deri para provës që dhanë në luftime, ata shiheshin si të dyshimtë, për shkak të luftës që qe bërë në Fushalie të Dibrës, në korrik të vitit 1944. E thënë ndryshe, luftimet e provokacioneve të gushtit 1949 u bënë shkak që të rehabilitoheshin dibranët. Në këtë aspekt, ndër më të dalluarit, përveç oficerëve Bajram Hysen Kovaçi (gazetar dhe shkrimtar i njohur) e Isuf Daci, nga Grykë-Noka, ai kujtonte edhe Arif Pitarkën po nga Grykë-Noka, që shërbente në postën e Vidohovës, si dhe të tjerët nga reparte të tjera si Fali Konozi nga Grykë-Noka, i plagosur, Sulë Daci po nga Grykë-Noka, Sali Pana nga Kodër-Leshej (i plagosur); të gjithë të dekoruar me "Medaljen e Trimërisë" etj.

Ndër shokët dhe kuadrot drejtues të rezistencës kundër agresionit të provokacioneve greke të 2 gushtit '49, Ademi ruante respekt të veçantë për kolonel Skënder Malindin. Kjo edhe për faktin se kolonel Malindi, i sapo kthyer nga Akademia Ushtarake e Bashkimit Sovjetik, në vitin 1947, e konsideronte Ademin jo si ushtar të thjeshtë, por si shok, të barabartë me të. Ndaj dhe organizatorët dhe pjesëmarrësit e asaj rezistence të pashembullt ndaj agresionit të monarkofashistëve grekë, meritojnë nderim të veçantë.

## HEROI

# Përjetësimi i heroit të kombit Tahir Sinani

Rajmonda MALEÇKA

**5** Maj 2024 - Pikërisht në Ditën e Dëshmorëve, Tahir Sinani, në Bajram Curr, është përjetësuar në bronz. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në zbulimin e shtatores së heroit të kombit, Tahir Sinani, e vendosur në Bajram Curr. Haradinaj ka thënë se Malësia e Gjakovës si vatër e atdhedashurisë rriti luftëtarë trima.

“Malësia e Gjakovës, vatër e atdhedashurisë dhe shqiptarisë ndër breza, përgjatë shekujve rriti luftëtarë trima e syptatrembur, siç ishte bashkëluftëtari im, Heroi i Kombit, Tahir Sinani nga Tropoja. Tahiri i takon brezit të patriotëve shqiptarë të lëvizjeve për liri, brezit të luftëtarëve të cilët ranë me armë në dorë që të jetojë i lirë shqiptari. Me heroizmin e tij në luftërat çlirimtare, nderoi jo vetëm Tropojën por mbarë kombin shqiptar”, ka thënë Haradinaj. Angazhimi i tij jetësor në shërbim të kombit shqiptar do të kujtohet e nderohet përgjithmonë!”, është shprehur Haradinaj.

\* \* \*

S’di pse një shkrim, i cili ka për qëllimin e vet të parë, të kujtojë një luftëtar të gjithë luftërave të shqiptarëve në fund shekullin e kaluar dhe këtë fillim-shekulli, si Tahir Sinani, të niste kështu. Ndoshta ngaqë duhej një parathënie, pastaj një kronikë e përgjakshme, kumtet e luftërave e pastaj për të ardhë tek njeriu i shquar i luftës. Është një ndërthënie dhe një realitet që lidhet pikërisht me peshën dhe kumtin që la pas Tahir Sinani. Është po ajo nevojë e kuptimësisë, që luftëtarët e lirisë, të kthyer në dëshmorë, heronj dhe kujtesë, për të cilët gjithmonë duhet të gesh një vend, një moment dhe realitet për t’i kujtuar, për t’i shpallur dhe për t’i vendosur. Tahir Sinani është njeriu i kësaj peshe dhe vlere. Është njeriu që ka patur një marrdhënie të tillë me historinë e popullit të vet, është një ndërgegje e krijuar me atë marrdhënie të çuditshme, e cila ishte e lidhur dhe funksiononte maksimalisht me lirinë e shqiptarëve.

Jo vetëm në të gjithë Kosovën, por të gjithë trevat ku shqiptarët kryen luftën e tyre më të drejtë dhe më dinjitoze, shenjat e luftës u mbyllën. Shtëpitë më së shumti u rindërtuan. Të bukura ashtu siç i bëjnë shqiptarët. Po ashtu dhe rrugët përgjatërojnë në maksimumin e tyre. Fëmijët shkojnë në shkollë, me atë dritën që ka sjellë liria e adhurueshme. Në varret e të rënëve asnjëherë nuk harrohet të vendosen lule dhe të thuhet përkushtime. Nuk mungojnë këngët që u ngrihen ditë pas dite trimave. Është një liri që ka historinë e saj, që nuk pranon harresë aspak. Kujtimet për të rënë përherë e më shumë po i afrojnë kohët dhe njerëzit akoma më shumë i kanë bërë ta kuptojnë lirinë në të gjithë dimensionet e saj.

Jeta, të gjithë atë që Tahir Sinani bëri në luftë dhe për luftën, i ngjajnë një epoke dhe janë sa një epokë. Tahir Sinani kishte një gen të lashtë të tokës shqiptare, që kishte pësuar fatin e hidhur të të larguarit nga vendi i vet ashtu siç po ndodhëte në popullsinë shqiptare në Kosovë, kur Tahir Sinani si një njeri i armës e njihte mirë se ç’duhej të bënte. Tahir Sinani kishte në mendje amanetin e babait të tij Mal Sinani, i cili kishte porositur në gjallje të vet: “Unë kam qenë djalë dëshiri dhe kam luftue për çlirimin e Kosovës. Nëse Kosova ngrihet në luftë kundër shkjaut, amanet po ja u lë, që bile njëri prej jush të shkojë atje e të luftojë për të çliruar atë pjesë të robëruar të Shqipërisë.” Është një amanet të cilin nuk e humb as koha e as e tret as dheu. Kuptohet mirë se lufta për Tahir Sinanin kishte fluar që herët, sa herë që i takonte nga Bujani i tij të dilte në kreshtat e Tropojës e t’i hidhte sytë mbi tokën e Kosovës. Kështu ndoshta ditë pas dite që plotësuar karakteri dhe cikli i një luftëtari. Prandaj Tahir Sinani do të mbetëte një kronikë e plotë e tre luftërave të shqiptarëve.



\* \* \*

Në vitin 1998 shumë pak shqiptarë mund të dinin se çdo të ndodhëte në vitin 1999. Askush nuk mendonte se lufta trokiste në portat e pjesës më të madhe të trojeve shqiptare nën-ish-Jugosllavi. Jo se shqiptarët nuk kishin kurajon, porse parimet e unitetit ndërkombëtrë pak mundësi i kishin lënë opsionit të luftës për ta zgjidhur nyjën e Ballkanit. Pikërisht atherë Tahir Sinani bashkë me eksponentët e njohur të UÇK-së dhe të luftës më vendimtare të shqiptarëve, po stërvitnin luftëtarët e ardhshëm të kësaj ushtrie. Njerëzit e njohur të UÇK-së si Azem Sylja, Bislim Zyrapi, Agim Çelaj, Xhelal Hajda e të tjerë, bashkë me strategun e ardhshëm të luftës Tahir Sinani, dukeshin se ishin të bindur se do të kishte luftë. Për fatin e mirë luftëtarët dhe të rënë për liri Agim Zeneli, Agush Gjocaj, Ilir Konushevcu do ta mësonin artin e luftës nga ky njeri i “prerë” për të luftuar. Dhe koha nuk pati të ndalur. Ndoshta ajo eci më shpejt se çdo herë tjetër.

Në nëntorin e vitit 1998 Tahir Sinani bashkë me trimat e tjerë arrin të kapë majat e Pashtrikut. Ndërkohë emërohet dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, pa harruar për asnjë çast përgatitjen e luftëtarëve të ardhshëm të lirisë. Divjaka e Kosovës do të jetë një nga qendrat e rëndësishme të kësaj kohe, ku Tahir Sinani, Bislim Zyrapi, Sali Veseli, Naim Maloku dhe të tjerë do të stërvitnin intensivisht njerëzit e luftës. Është koha kur nga Shqipëria do të vërshonin kuadro të sprovuar ushtarak në ndihmë të luftës. Është koha kur puna e njeriut të luftës do të hidhet në terren. Tahir Sinani është ndër të parët që e realizoi këtë akt madhorë dhe tepër vendimtarë. Është koha kur vetë njerëzit, që Tahir Sinani i kishte shndërruar në luftëtarë të ardhshëm të luftës, e pagëzojnë me emrin kuptimplotë Tahir Tropoja. Një zakon i njohur në kohë luftërash ndër shqiptarët e Veriut ky. A nuk qe quajt kështu dhe Azem Galica!?

Shpejt emri i Tahir Tropojës do të qe kryeradha e komunikatave të UÇK-së si një figurë prej nga merrnin kurajë, guxim dhe motive të gjithë njerëzit e luftës. Në CV. e luftës së Tahir Tropojës shënohet minosja e vendit afër pikave ushtarake të armikut

në fshatin Zboc. Dihet mirë se ka patur shumë dëme në këtë rast. Po ashtu nën komandën e tij trupat armike nuk mundën të hyjnë në Blinajë, në Sllupçan, në malet e Zatriqit dhe as në Malishevë. Aksioni i Njësisë Speciale të Shtabit të Përgjithshëm, ku u vranë tre policë serbë, kanë ideator dhe realizues Tahir Sinanin.

Futja e trupave të NATO-s në Kosovë dhe vepimet e mundëshme luftarake, që mund të lindnin në këtë rast, në konflikt me makinerinë ushtarake dhe policore serbe, e vunë në radhën e parë të sigurisë të Zonës Operative të Pashtrikut Tahir Sinanin, ku ndodhej Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Ndërkohë në këtë zonë malesh dhe grykash ishin zhvendosur mbi 100 mijë banorë, të cilët mbroheshin nga luftëtarët e UÇK-së që në muajin prill të 1999, njëri prej komandantëve ishte dhe Tahir Sinani. Ai kishte lëshuar këtë kushtrim: “Me asnjë çmim, qoftë dhe me çmimin e jetës së krejt ushtarëve, serbët nuk do t’i lejojmë të depërtojnë tek popullata.”

Dikurë njeriu famëkeq serbi Sheshel ishte shprehur se shpejt do ta pinte kafënë në Berishë, ndërsa vrasari Ojdaniq, kishte thënë se do të ngrinte fushë futbollit në Berishë. Thirrjet e vrasësve të shqiptarëve për Tahir Sinanin i ngjanin vdekjes dhe ai qe betue për të mos i lanë vrasësit t’i realizonin ëndërrat e tyre. Në Berishë ëndërronte ta pinte kafënë i lirë njeriu i lirisë Tahir Sinani, i cili qe bënë njësh me andrën e shqiptarëve.

Gjatë vitit 1999 Tahir Sinani udhëhoqi shumë aksione luftarake në të gjithë Zonën Operative të Pashtrikut, ku ai qe dhe komandant. Operacioni i njohur “Shigjeta” në Pashtrik ka në “mekanizmin” e vet mendjen dhe aftësitë e Tahir Sinanit, bashkë me njerëz të tjerë të aftë për të realizuar të tilla detyra ushtarake.

12 qershori i vitit 1999 gjen fitimtar dhe triumfatorë në qytetin e pizrenit dhe Tahir Sinanin, të cilit i kishte hije ai kthim prej luftëtari dhe njeriu të lidhur me fatet dhe detyrimin ndaj atdheut.

Ndoshta pa i ikur lodhja nga këmbët e shpatullat, ndoshta pa ju ngopur syri me gjumë, Tahir Sinani

(Vijon në faqen 15)

## PROFIL

# DAUT HOXHA, ANALIZA PSIKO-SOCIALE DHE HISTORIA E NJË QYTETI PAFUND

Nga Pol Milo

Në qytetin bregdetar të Durrësit, kur fryn fladi i detit gjithmonë takoj një profesor fisnik dhe humanist, i cili jeton dhe e një qytetin përtej shumë periudhave dhe ngjarjeve mes njerëzve me të cilët ka jetuar dhe punuar. Bëhet fjalë për shkrimtarin, analistin, historianin dhe profesorin e nderuar Daut Hoxha. Është një vlerësim i madh qytetar kur intelektualë si profesor Daut Hoxha, që ka qenë pjesë e historisë së qytetit, i tregon vetë vlerat e njerëzve me të cilët ka bashkëjetuar dhe bashkëpunuar, në zhvillimin dhe analizën e jetës sociale.

Një pjesë e madhe e këtyre historive janë përfshirë edhe në veprat e autorit, përfshirë këtu ditarin e tij, ku ngjarjet dhe datat janë specifikuar në mënyrë arkivore. Jo më kot ditari i tij mund të cilësohet si ditari i një qyteti.

Ngjarjet në të janë të lidhura ngushtë jo vetëm me jetën sociale në qytet, por kryesisht me marrëdhëniet njerëzore, me takimet, ngjarjet, episodet dhe analizat e shënuara aty, me shkrim dore dhe stilolaps, datë pas date, ditë pas dite, ngjarje pas ngjarje. Në këtë mënyrë, takimi me profesor Dautin është si të takohesh me historinë, është takimi me ngjarjet e qytetit, kur kthehesh pas në kohë dhe analizon realitetin social dhe qytetar nga një këndvështrim krejtësisht ndryshe dhe origjinal.

Nëpërmjet pikëpamjeve të tij, aftësisë analitike dhe botës intelektuale që ka marrë pjesë, ai sjell jo vetëm një tablo historike, por një analizë të mirëfilltë psiko-sociale. Ai bën një ndërthurje analitike mes dy apo tri kohërave të qytetit, nga një këndvështrim krahasimor, duke sjellë shembuj të jetuar. Analiza psiko-sociale gjendet dhe në krijimtarinë e gjërë letrare, e pasqyruar në përmbledhjen e veprave të tij. Në përmbledhjen e vepra me katër vëllime, kuptohet thellësia e analizës së tij si një psikolog i mirëfilltë social.

Duke qenë se ai ka rritur dhe arsimuar breza të tërë me nxënës të shkëlqyer të shkollave, komunikimi i tij ka qenë sa i dashur dhe i respektuar e dashamirës aq edhe i rreptë, korrekt dhe kërkues të një sjelljeje të drejtë qytetare.

Krijimtaria e autorit sipas botimeve ndahet në poezi me vëllimet "Dhimbja e zemrës dhe shpirti", "Pulëbardha", tregime me vëllimet "Venedikta dhe Jetë midis dy dashurive", "Një natë me stuhi", "Jetë në shi", romane me "mGruaja me të zeza", "Vdekja e bretkosave", "Ishte kohë lufte", studimin "Socialdemokracia-ideali që frymëzoi reformimin", dhe ditarin "Na e vranë ëndrrën". Në romanin "Gruaja me të zeza" ai analizon temën e emancipimit të femrës shqiptare, nëpërmjet një konflikti



të butë dhe të adhurueshëm. Ai argumenton procesin historiko-social përmes ardhjes së asaj që ai e quan koha e riorganizimit ndryshe të femrës shqiptare, ku shpërthimi i femrës erdhi si pasojë e shkollimit të tyre. Në shkollimin e femrës shqiptare ai veçon tre gupime kryesore, shkollimi nëpërmjet gjimnazit, shkollimi në shkollat profesionale dhe shkollimi universitar, brenda dhe jashtë. Këto veçori të emancipimit studimor sollën dhe reflektimin në emancipimin social. Ndërmjet profesionistëve, mësuesëve e pedagogëve, ai kujton ata të cilët pasi kishin studiuar jashtë vendit ishin kthyer të jepnin mësim në Durrës. Në këto grupime përmenden ata që kanë studiuar në Gras të Austrisë, në Krakov të Polonisë, në Moskë apo Itali, Çeki, etj, ku profesionalizmi ishte shumë i madh me përgjegjshmëri të lartë. Kështu që formimi social i individit vjen i plotë, ku ai bëhet i aftë të përfaqësojë rendin e tij politik dhe politikën qytetare në vëzhgim.

Profesori durrsak Kadri Tarelli, në esenë e tij "Sa shumë miq e shokë ke, O Shpendi Topollaj!" evidenton në mënyrë ekselente miqësinë e Shpendit me profesor Daut Hoxhën nëpërmjet përfshirjes së tij në Librin me Aforizma. Profesor Meçan Hoxha thotë në esenë e tij studimore se Dauti është autor, në një farë mënyre edhe personazh, së bashku me qytetarët e Durrësit dhe të vendit. Besoj se është i vetmi në botën shqiptare, që ka mbajtur një ditari të tillë. Çdo faqe e këtij libri, është një fotografi që fikson kohën. Aty rrjedh jeta e Durrësit dhe e durrsakëve, fillimisht me moshë të re, por që i pjek dhe i plak koha, duke e bërë përfaqësues të një teme filozofike, që mund ta quajmë pa frikë Dautizmi filozofik, një përfaqësim i një analize krejtësisht ndryshe.

Fatmir Minguli e quan: "Ditari monumental", ku çdo durrsak gjen veten, në mos emrin e tij, gjen far-

efisin apo të njohurit". Me Dautin duhet vepruar ndryshe, ai duhet ndihmuar që të flasë sa më shumë duke botuar libra të tjerë, duke i kujtuar se asnjëherë nuk është vonë. Në librat e Dautit spikat gjithmonë një djalë i ri që gëzon jetën, lufton kundër pengesave. Ky djalë është ai lëngu lidhës midis qytetit të dashur dhe jetës së njerëzve që lëvizin brenda qytetit. Po t'i shohësh me kujdes poezitë delikate, të mbushet mendja plotësisht. Ky i ri na tregon për kampet e punës në vitet 1952-1953, na flet për një dashuri të lënë përgjysmë, për fakultetin e Tiranës, për udhëtimin me trenin e paharruar Durrës-Tiranë, për kontakte të larme me njerëz, për lulet e qytetit, detin... Është ky djalë që gjithandej është i gatshëm për çdo punë, do gëzim, do përmirësim, por... i dalin përpara të pashkollët me pushtet që nuk donin të përmirësonin qoftë edhe diçka, jo vetëm për ata që vuanin në burgje për probleme idesh ndryshe, por edhe për gjithë njerëzit që ishin të lirë në jetë, por të burgosur për idetë përparimtare.

Në librat e tij, Daut Hoxha na kujton se shpresa dhe rezistenca janë thelbësore për mbijetesën tonë si njerëz.

Pavarësisht nga errësira që na rrethon, ai na tregon se ka gjithmonë një dritë, një shpresë për një të ardhme më të mirë. Ky është mesazhi i tij për ne: të mos dorëzohemi kurrë, të luftojmë gjithmonë për atë që besojmë dhe të ruajmë gjithmonë ëndrrat tona, pavarësisht nga vështirësitë që mund të na dalin përpara.

– Ky qytet – thotë profesor Dauti – është një qytet psikologjik dhe social, me histori pafund. Një nga aktet më dashamirëse të qytetit të durrsakëve është që ai, i ka shtrirë dorën vazhdimisht të ardhurve, me mikpritjen e tij që nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Historia dhe kultura durrsake ka ditur të mbizotërojë në forma të

ndryshme edhe në momentet më absurde, siç është edhe bashkëjetesa e stileve të ndërtesave mes stilit italian dhe stilit turkoshok, stil i kulturës qytetare turke. Këtu ka veçanti të një arkitekture marramendëse. Në vijim të kulturës italiane duhen përmendur të paktën katër kinematë në qytet, kinema Esperia në pronat e familjes Zaja, kinema Gloria në pronat e familjes Zaharjan, kinema Duka D'Ostia në afërsi të gjimnazit Gjergj Kastrioti, dhe kinema Ushtari brenda në godinës së bashkisë, ku ushtria italiane transmetonte filma për rininë qytetare të kohës. Nga operatorët e parë kinematografik ishte edhe Sulejman Gallai, që më vonë u bë kryetar i fermës së parë bujqësore Sukth si shoqëri konçensionare të cilën e administronte vetë Konti Ciano, gjatë viteve '30, ndërsa për problemet kulturore të qytetit duhen përmendur familje të famshme durrsake si familja Ziu, familja Leka etj. Pronari i parë i spitaleve durrsake, ka qenë lushnjar nga Shorohova e Myzeqesë që ka nxjerrë figura të shquara si Bab Dudë Karbunara!

Ai përshkruan me detaje të jashtëzakonshme vuajtjet e njerëzve të thjeshtë, ata që përballeshin me sfida të pambarimta, por që gjithmonë gjenin forcën për të ecur përpara. Në çdo faqe, ndien dhimbjen e tyre, por edhe vendosmërinë dhe guximin për të mos u dorëzuar kurrë. Këto tregime nuk janë vetëm një pasqyrim i realitetit të kohës, por edhe e forcës së pabesueshme të shpirtit njerëzor.

Daut Hoxha është një zë i fuqishëm dhe i domosdoshëm në letërsinë shqiptare. Ai na sjell histori që na bëjnë të reflektojmë dhe të ndiejmë, histori që na kujtojnë se jeta është e bukur dhe e vështirë, por që gjithmonë vlen të jetohet me kurajë dhe pasion.

Në një botë ku shpesh ndjehemi të humbur dhe të pashpresë, shkrimet e tij na kujtojnë se ne kemi fuqinë për të ndryshuar fatin tonë, për të luftuar për atë që besojmë dhe për të mbajtur gjallë ëndrrat tona. Ai nuk shkruan thjesht për të argëtuar, por për të ndriçuar shpirtin tanë, për të na kujtuar se edhe në momentet më të errëta, ne mund të gjejmë forcën për të vazhduar përpara.

Në çdo faqe të librave të tij, ndien zemrën e tij që rreh për drejtësi, për dashuri dhe për shpresë. Shkrimet e tij janë një testament për forcën dhe rezistencën e shpirtit njerëzor, dhe një thirrje për të mos harruar kurrë se kush jemi dhe për çfarë luftojmë. Përmes veprës së tij, Daut Hoxha na kujton se të gjithë ne kemi një histori për të treguar, një ëndërr për të ndjekur dhe një dritë për të ndjekur, pavarësisht nga sa e errët mund të duket rruga jonë. Ai është një zë që ngre lart të përulurit, që i jep kurajë të dobëtëve dhe që i kujton të gjithëve se jeta, me të gjitha sfidat dhe bukuritë e saj, vlen të jetohet plotësisht dhe me gjithë zemër.

## PROFILI

*Simbol i dijes, përkushtimit qytetar, paqes dhe dashurisë*

# FERIT KËPUTA – Mësuesi veteran, studiuesi e shkrimtari që la vepra dinjtitoze

**BAJRAM CANAMETI**

**Q**ë kur ngriti grupin artistik të valleve në shkollën e Bruçit e deri sa mbylli sytë në moshë të shtyrë, Ferit Këputa nuk iu nda punës së palodhur në dobi të arsimit, kulturës dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Mësues i dalluar, studiues, hulumtues, aktivist dhe masovik i kulturës, skenarist dhe njëherit regjisor, ai do të lërë gjurmë të pashlyera duke kryer disa punë si përgjegjës i Vatrës së Kulturës, duke ngritur ansamble artistike të cilat me programet e tyre të pasura do të regjistroheshin në RTVSH. Ai do të krijojë edhe këngë të cilat do të futen në repeertorin e Festivaleve Folklorike Kombëtare.

Njeri i interesave të gjera dhe i kontakteve të gjalla me njerëzit, i dëgjueshëm dhe debatues me argumenta kokëkforta, kështu do të mbahet mend ai, një personalitet që ia kushtoi jetën studimit të historisë duke ftuar disa historianë të Akademisë së Shkencave dhe duke i çuar nëpër vende në Mat ku ishin gjurmët e Skënderbeut. Këto vende ishin topose, kështjella, të cilat shoqëroheshin me legjenda e tregime për Skënderbeun.

Por Feriti nuk ishte vetëm një gjurmues i arkivit të gjallë, por edhe studiues dhe sistemues i arkivit të dokumentuar.

Studiues dhe i vëmendshëm ndaj debatateve të kohës mbi origjinën e Skënderbeut ai dha dëshmi se Skënderbeu është me origjinë nga Mati dhe këtë e provoi me librin e tij "Origjina e Skënderbeut është Mati". Në këtë libër me dokumente arkivore, Feriti provon se origjina e Kastriotëve është Mati, një libër që doli jo si tendencë për të përmbysur teoritë e tjera as hamendësimet amatoreske, që nuk bazohen mbi të dhëna, por mbi qëllime të tjera. Me këtë libër, krahas historianit tjetër matjan Qamil Alushi, i cili shkroi librin "Skënderbeu nga Barleti tek Oliver Schmid", Ferit Këputa vendos dhe përçon një rrjedhë arsyetuese që nuk pranon të notohet kundër saj.

Dashuria për vendlindjen shprehet tek ky njeri së pari në njohjen e historisë së saj sidomos kur është fjala për Matin, këtë trevë të njohur, ndaj do ta thellonte këtë punë dhe do t'i jepte krah kësaj dashurie me librin mjaft të rëndësishëm "Mati në kulmet e historisë kombëtare", ku autori evidenton disa ngjarje të rëndësishme në historinë e Matit, që rezonojnë në historinë klombëtare dhe anasjelltas. Ai e shikon historinë e Matit si pjesë integrale e historisë kombëtare dhe evidenton pikërisht ato ngjarje të cilat përbëjnë pikën kulmore të ekzistencës së kësaj krahine dhe të kombit në tërësi, ku pasqyrojnë më së miri me dokumenta ato figura dhe ngjarje sa dramatike aq edhe burrërore, duke sjellë kështu në mënyrë bindëse dhe me metoda shkencore që përvijohen nga fakti tek argumenti dhe nga argumenti te dokumenti ose nga e treta drejt së parës.

I dashuruar me figurën e Skënderbeut, ai vijon librin tjetër "Mati dhe Skënderbeu" ku dokumenton të dhëna arkivore dhe i përqsas ato me dëshmi gojore, natyrisht një punë e dobishme ku spikat edhe ana tjetër e tiparit të punës së tij shkencore: etnografia dhe folkloristika, etnografia dhe burime të tjera kulturore që dalin nga kujtesa popullore dhe që përbëjnë një argument më vete.

Më tutje, vijojnë librat e tij: "Mati në shekullin XX", "Matjanët në Luftën e Dytë Botërore", "Ismail Terziu shqipe mali", "Laçi- Bruçi dhe Uraka".

Duke qenë një mësues i përkushtuar e duke punuar në këtë zonë deri në Martaneshin e largët, Ferit Këputa la gjurmë të pashlyera dhe fitoi mirënjohjen e brezave që edukoi me dashurinë për dijen,



**• Ajo që vihet re tek ky personalitet që punoi në heshtje, është riorganizimi shkencor dhe ftesa për debat për mjaft probleme të historisë, me qëllimin që historia të mos shkruhej mbi bazë oreksesh ose nga politika e ditës. Ishte në një farë mënyre një historian që të hidhte dorashkën për debat shkencor dhe pranonte vetëm vërtetësinë e faktit dhe këtë të mbështetur mirë jo mbi sajesa, por mbi dokumenta të besueshme dhe origjinale**

për atdheun dhe me virtyte qytetare.

Libri i tij "Arsimi dhe kultura e Matit - vështrim historik", është një kujtesë e saktë që përcjell nivelet kohore të zhvillimit arsimor në këtë trevë, vështirësitë e para por edhe pasionin e madh për dije.

Formimi i tij si malësor me tradita dhe shkollimi i lartë, plus pasioni dhe këmbëngulja në hulumtimin shkencor, përbëjnë tri tipare të arrira të këtij njeriu të dalluar në fushë të dijes, të cilat gjenden sot në librat e tij, por edhe në punimet shkencore - artikujt që botoi te gazeta "Bashkimi" në krye të herës e më vonë te gazetat Republika, "Atdheu", "Standard", "Mati", "55", "Tirana Observer" etj.

Një personalitet shumëdimensional me interesa të gjera dhe me njohje të madhe që vinte nga puna studimore, ai herë - herë i tejkalon interesat historike, ndërsa shkruan librin "Shërbimi shëndetësor në Mat", një libër analitik, por edhe me informacion të detajuar dhe të saktë. Ky libër jep një rrugë të gjatë dhe të vështirë të shërbimit shëndetësor në rrethin e Matit, duke sjellë edhe ato risi të zhvillimit të institucioneve shëndetësore dhe të kulturës shëndetësore, pa e shkëputur atë nga reformat politike dhe sociale.

Ajo që vihet re tek ky personalitet që punoi në heshtje, është riorganizimi shkencor dhe ftesa për debat për mjaft probleme të historisë, me qëllimin që historia të mos shkruhej mbi bazë oreksesh ose



nga politika e ditës. Ishte në një farë mënyre një historian që të hidhte dorashkën për debat shkencor dhe pranonte vetëm vërtetësinë e faktit dhe këtë të mbështetur mirë jo mbi sajesa, por mbi dokumenta të besueshme dhe origjinale.

Dashuria për historinë krahinore, por edhe kombëtare duhej mbështetur patjetër edhe në aftësinë në përvetësimin e dijes dhe kësaj ia doli me sukses, ashtu si dhe kjo nismë e vijimësi prej punëtorit të madh të dijes, kërkonte edhe aktivizimin e tij në veprimtari sociale, kulturore dhe për këtë formon shoqatën: "Ahmet Zogu", ku, duke bërë disa kërkesa të argumentuara, bindi instancat e pushtetit që sheshi në Burrel të merrte emrin "Ahmet Zogu", ndërsa në Tiranë Bulevardi te Stacioni i Trenit të merrte emrin "Zogu I".

Kjo punë nuk ishte diçka e thjeshtë, por ai ia doli mbi bazën e kërkesave dhe argumentimeve të bazuara, sepse qëllimi i tij nuk ishte përdorimi i historisë për politika të caktuara, as evidentimi i saj në gjëra të njohura si ripërsëritje, por plotësimi i historisë dhe hulumtimi i saj në mënyrë që ajo të riformatohet në të gjitha dimensionet e saj duke nënvizuar luhatjet apo kontrastet e saj.

Një punë e tillë fitoi në radhë të parë simpatinë e lexuesit të interesuar për historinë, por edhe vlerësimin e instancave shoqërore e shtetërore, ku Ferit Këputa do të vlerësohet me "Mirënjohja" nga komuna Martanesh e me çmimin "Pena Budi" nga revista "Emathia", e kjo do të kulmojë me dhënien e titullit "Qytetar Nderi" nga Bashkia Burrel.

Këputa është një studiues i shquar që do të mbahet mend gjatë për librat që la, të cilat janë burim i pashtershëm informacioni, pasuruar me të dhëna të reja, po kështu edhe për aktivitetin e tij në dobi të shoqërisë, duke përcjellë shembullin e një burri të ndershëm, shkencëtar serioz në rrjedhën e krijimtarisë së tij. Ai nuk u nis të plottëson te ndonjë boshësi që kishin lënë të tjerë studiues, por me punën e tij arriti ta bënte këtë dhe ia doli. Të tjerë studiues do të mbushin boshësi të pritshme, me qëllim që historia jonë kombëtare të shkruhet dhe të kuptohet drejt pa ngjyriime dhe orekse të njërit apo tjetrit.

## LIBRI

Shënime kritike për antologjinë me poezi të zgjedhura “Shqipëri, zemra jonë” të Trandafille Molla Baja, Lenagrafik, Prishtinë, 2024

# Një antologji kozmogonike dhe guximi i një poeteje

Fatmir Minguli

Antologjia me poezi të zgjedhura e përgatitur nga poetja Trandafille Molla Baja është një risi në vargun e pafund të antologjive poetike që botohen në mbarë trojet shqiptare dhe në diasporë.

Por me këtë antologji vështrimet marrin një ndriçim tjetër, një ndriçim që nuk gjindet kaq bukur dhe në antologji të ndryshme. Ky ndriçim është i shoqëruar me një fakt sa të dhimbshëm aq dhe të bukur. Esh-të dhimbja e poetëve për atdheun, është shpalosja e shpirtit të tyre për të shprehur atë dashuri që është mbi të gjitha dashuritë, atë dashuri që ecën paralel edhe me dashuritë e jetës njerëzore.

Por poetja e palodhur Trandafille Molla Baja është tejet e bindur për sa ka pasur idetë në projektin e saj për të prurë në duart e shqiptarëve kudo që ndodhen një vademekum që flet për dashurinë ndaj tokës mëmë.

“Shqipëri, zemra jonë” është titulli që e shpjegon fare lakonisht, fare bukur, fare kuptueshëm përmbajtjen e poezive dhe rrahjet e zemrave të poetëve që janë përfshirë në këtë enciklopedi të dashurisë për atdheun.

Edhe kur lexon një nëntitull të shkruar me germa të vogla në kapakun e këtij libri “Poezi të zgjedhura” merret me mend se sa punë kolosale është bërë për të seleksionuar, dalluar, sistemuar poezitë që kanë marrë “lejen” e autores për t’u futur në këtë antologji. Janë 80 poetë që janë përfshirë në këtë antologji kozmogonike.

Pse e quaj antologjinë e Trandafille Molla Bajës “kozmogonike”? Në të vërtetë është e vështirë të përgjigjem, por tek lexon emrat e poetëve dhe poetëve, kur lexon poezitë e tyre aq të ndryshme por aq shumë afër shprehjes së dashurisë për tokën amë, mendoj se kam të drejtë.

Autorët që marrin pjesë janë nga shumë vende të ndryshme. Edhe po të them se shumica janë emigrantë, nuk gaboj, edhe po të them se shumica janë nga Kosova, nuk gaboj, edhe po të them se shumica janë poetë, prap nuk gaboj. Po, ky është dhe thelbi i kozmogonizmit të kësaj antologjie me vlera optimale në përcaktimin klasifikues të një antologjie me përmasa të tilla.

Shumë antologji janë botuar kryesisht për dashurinë, dhe nuk është keq, përkundrazi. Por brenda dashurisë për tokën mëmë janë të gjitha dashuritë. Është si të thuash një thirrje që vjen që nga “Këngët e Solomonit “ të Biblës ku flitet që para lindjes së Krish-tit mbi dashurinë universale dhe që ky titull shoqërohet herë pas here me titullin tjetër domethënës “Kantikum Kantikum” ose “Kënga e këngëve” që aq bukur e ka shqipëruar poeti i madh Moikom Zeqo!

Raporti mes dashurive është i çuditshëm dhe lidhet me ndjenjat njerëzore por dashuria për atdheun, për Shqipërinë, zemrën, jo vetëm të poetëve, është universale. Dhe ky atdheu është nëpër poezitë që poetët i kushtojnë Shqipërisë, Kosovës, Camërisë, Preshevës, Reçakut, dhe pastaj vendeve emblema si Tomorri, Rozafa dhe heroNjve që nga Skënderbeu e deri te çerçiz Topulli.

Shumë kush do të kuptojë se shumë poezi të kësaj antologjie janë të shkruar nga poetë që janë në emigracion. Është dhe nuk është e vërtetë.

Kozmogonizmi i kësaj antologjie lidhet drejt për së drejti me guximin e poetes Trandafille Molla Baja në përzgjedhjen e poezive dhe pas tyre të autorëve.

Le të sjell dhe mendimin e studjuesit mirditas Ndue Dedaj për vlerat e kësaj antologjie të shprehura në parathënien e librit dhe që e titullon me të drejtë “Gjeografi e poezisë shqiptare”

Guximi i autores është për më tepër mbi hapësirat ku ajo ka shëtitur të mbledhë nektarin e sa më shumë luleve të forta me aroma poetike për atdheun.

Ajo shkon te Dhimitër Nica në Selanik e kthehet te Robert Shkurti e Myftar Gjonbalaj në Itali, autorë që kanë botuar në studion durrsake shtëpi botuese 2M,



pjesë e së cilës ka qenë dhe vetë Trandafille Molla Baja apo dhe Pranvera Belba në Gjermani, pjestare të kësaj antologjie.

Por Trandafilja ka meritën e madhe që është përqëndruar shumë bukur në poetët kosovarë që dashje pa dashje zenë edhe numrin më të madh në këtë antologji. Ka meritën se nuk ka bërë dallime të sistemit klasifikues, por renditjen e ka bërë sipas orientimit të vet personal dhe ka të drejtë.

Në poezinë e saj që e ka futur në antologji “Dua-je tokën ku u lindi” duket sikur i këndon paralelisht atdheut dhe vetë punë së saj për përgatitjen e kësaj antologjie:

*Një tokë e ashpër duhet me kujdes punura,  
Edhe pse ajo është e egër, e fortë,  
Djepi i saj të ka përkundur, s’duhet harruar  
Të tjetët të lakmojnë, ruaje e mos derdh lot.*

Natyrisht paralelizmi është metaforik, por dua të theksoj se sa vështirësi ka përgatitja e një antologjie, ku post botimi mund të ketë dhe vretje...

Por është ajo që përmenda që në titull të këtij shkrimi kritik, është guximi i një femre poete të suksesshme që nderon vendin e saj dhe vretjet ajo do i presë me armën e guximit të saj proverbial.

Trandafille Molla Baja sjell në këtë antologji emra të njohur të poezisë shqipe si Myrteza Mara, Përparim Hysi, Faik Xhani, Iliaz Bobaj, Flora Brovina, Viron Kona, Kujtim Stana, Hamdi Hysuka, Shyqri Galica, Petra Risto, Ndue Lazri, Zhuljeta Grabocka (Çina), Tyran Prizren Spahiu, Lumo Kolleshi, Polo Çipa, Xheladin Mjeku, Xhemile Ademi, Lulzim Hajdari, Migena Arllati, etj.

Të më falni që përmenda vetëm këta emra të cilë i preferoj personalisht por janë me dhjetra e dhjetra të tjerë që autorja e antologjisë i ka futur për secilin me tre apo katër poezi. Është kjo një risi e Trandafille Mollës e cila e ka për herë të parë përpilimin e një antologjie poetike veçanarisht për tokën amë.

Por edhe kritikët më të famshëm amerikanë apo evropianë e kanë të vështirë të hartojnë antologji poetike, sespe çdo gjë është fakultative, është si të thuash që antologjia ndërtohet sipas shijeve letrare të autorit të saj. Por kjo nuk ndodh me antologjinë e Trandafilles sepse ajo e njeh këtë lloj difekti por ashtu e mençur si e ka bërë zoti ka përzgjedhur autorë që i këndojnë atdheut. Kjo është ajo metafora e “Këngës së këngëve” që përmenda në krye të kësaj analize.

Nëse kjo autore do shohë se antologjia e saj ka nevojë që t’i bëhen vretje, mendoj se nuk ia vlen t’i bësh vretje.

Ndoshta do të shtonte një poet që është në emigracion dhe mjaft i sukseshëm si Kujtim Hajdari apo një poet që i këndon parreshtur vendlindjes së tij amërisë, Hekuran Halili.

Aspak nuk ia prishin bukurinë kësaj antologjie magjike emrat që nuk janë përfshirë sepse antologjitë janë si lastaret e pranverës, shtohen dhe rilindin dhe antologjitë ndjekin njera tjetrën.

Kjo antologji sikur e ka metaforën e saj te një strofë e poetit Kasem Shaqirvela marrë nga poezia “Gjithka tretet”, pjesë e antologjisë :

*Sa herë që ndjek mbarësi  
Dhe uron për miqtë e tu  
Shkurton largësinë me mirësi,  
Endjen tënde, tutje e tëhu.*

Bukur e ka shkruar, është dhe transkripti poetik i antologjisë së Trandafille Mollës Baja. “shkurton largësinë me mirësi ...”

## Përjetësimi i heroit të kombit Tahir Sinani

(vijon nga faqja 11)

bër përsëri tutje në luftë. Ai bashkohet me UÇPMB dhe pse pas luftës UÇK-ja e kishte bërë komandant të Qendrës së Stërvitjes dhe të Doktrinës në Nashec, e më pas në TMK. Në këtë ushtri ai u evidentua si njeri luftime në betejet e Konçulit, Dobrosinet dhe të Bujanocit. Me një dashuri luftëtarësh njerëzit e këtyre anëve e quajtën Tahir Presheva. Kujtimet për Tahir Preshevën i sjellin njerëzit e luftës në këto anë si Shefqet Musliu, Ridvan Musliu dhe Jonuz Musliu.

Angazhimi në luftën që Ushtria Çlirimtare Kombëtare zhvilloi si akti i fundit i padrejtësive, që ishin ushtruar dhe po ushtroheshin mbi shqiptarët në Maqedoni, tregoi se Tahir Sinani qe fort i lidhur me fatin historik i trojeve shqiptare. I njohur si një strateg i provuar në luftë, ai vihet në krye të udhëheqjes së kësaj ushtrie në bashkëpunim me njerëzit e njohur të kësaj lufte si Gëzim Ostreni

dhe Ali Ahmeti. Thuhet se e ndoqën nga pas të gjithë bashkëpunëtorët dhe luftëtarët me të cilët ai luftoi në të gjithë luftërat e mëparshme. Përmes malit të Korabit, ku thuhet se festoi dhe një ditëlindje, ai hyn në Tanushë të Gostivarit. E quajtën Tahir Tetova. Ku shkeli këmba e Tahir Sinanit armiku pësoi vdekjen, ndërsa njerëzit e nevojshëm për ndihmë fituan sigurinë. Ra më 29 korrik të vitit 2001. U varros në Kukul Zabel të Tanushës dhe me 24 maj të vitit 2002 u rivarros në Varrezat e Dëshmorëve në Lladovicë të Prizrenit. Qe dhe mbeti luftëtar, komandant dhe një atdhetar i shkëlqyer.

Është nderuar me të gjithë titujt dhe gradat që institucionet, shoqatat dhe hierarkia ushtarake në Kosovë ka akorduar për luftëtarët e lirisë. Për Tahir Sinanin janë ngritur përmendore, janë thurë balada dhe këngë, prej nga ai ka marrë fatin e të qenit i përjetshëm.

Është fat, kështu e kam njohur unë personalisht Tahir Sinanin.

FOTOREPORTAZH

# 30 VJET OBVLP, HISTORI SUKSESI

